



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 588 Akti

Nr.517 Vendimi
Tiranë, më 15.03.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 15.03.2022, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arian Xhaferraj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arian Xhaferraj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj, u shortua në datën 15.6.2020. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Alma Faskaj dhe anëtarë komisionerët Etleda Çiftja dhe Suela Zhegu.

3. Në vijim, trupi gjykues nr. 8, me vendim nr. 1, datë 20.6.2020, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin deklaroi me *e-mail* në datën 7.12.2020 se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vijim u administruan raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

5. Me vendim nr. 2, datë 21.2.2022, trupi gjykues vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arian Xhaferraj, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes. Po në të njëjtën datë, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë, brenda datës 4.3.2022.

6. Në vijim, subjekti rivlerësimit tërhoqi dokumentacionin me dosjen e hetimit në datën 23.2.2022 dhe dërgoi me *e-mail* prapësimet mbi rezultatet e hetimit në datën 3.3.2022.

7. Në vijim me vendim nr. 3, datë 7.3.2022, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Arian Xhaferraj në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 11.3.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 11.3.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Arian Xhaferraj u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në seancë dëgjimore

9. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Z. Arian Xhaferraj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, ka dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse, sipas kërkesës së Komisionit, në përputhje me kriteret e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT KALIMTAR I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes

së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit Arian Xhaferraj, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për këtë subjekt, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

13. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse. Por, referuar vendimit nr. ***, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

16. Subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur) në datën 26.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

17. Subjekti i rivlerësimit deklaron prej vitit 2015 dhe në vijim pa ndërprerje, është me status civil i martuar¹ dhe ka 1(një) fëmijë të mitur.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

18. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë dhe likuiditetet si vijon:

1. Automjet tip “Ford Focus”, regjistruar pranë DPSHTRR-së Durrës, blerë në vitin 2015, në vlerën 990 euro. Pjesa takuese: 100%.

¹Certifikatë të përbërjes familjare të datës 20.1.2017 dhe certifikatë të fëmijës së mitur të datës 25.1.2017.

19. Subjekti me deklaratën *Vetting* ka depozituar kthim përgjigjen² e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Durrës të cilës i bashkëlidhet praktika e regjistrimit të mjetit me targa ***.

20. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³.

21. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: rezultoi nga hetimi se kjo pasuri është krijuar në vitin 2015 dhe subjekti e ka deklaruar për herë të parë në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës të vitit 2015, ku në rubrikën deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit ka deklaruar: “*Automjeti tip ‘Ford Focus’ regjistruar pranë DPSHTRr-së Durrës, blerë në vlerën 990 euro. Blerë me të ardhurat e kursyera nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës*”. Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “*...shitur automjeti tip ‘Ford Focus’, me targa ***, në shumën 1,700 euro. Kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 6.10.2017*”.

22. Në vijim të korrespondencës së Komisionit me institucione publike për këtë pasuri, DPSHTRr-ja⁴ depoziton në Komision praktikën e regjistrimit të automjetit tip “Ford Focus”, me targa ***. Referuar praktikës së përcjellë në Komision për mjetin me targa *** me nr. shasie ***, vit prodhimi 2002, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin nga shtetasi italian P.B, në vlerën 990 euro.⁵ Pas kryerjes së procedurave të regjistrimit në Shqipëri, mjeti ka marrë targën ***. Me kontratën nr. ***, datë 6.10.2017, subjekti i rivlerësimit i shet shtetasit L.K automjetin tip “Ford Focus”, në vlerën 1,700 euro.

23. AMF⁶ dhe AMF *online* për mjetin me targa *** informojnë se për periudhën 31.12.2015 – 7.2.2017, subjekti i rivlerësimit figuron pronar i automjetit.

24. Komisioni i drejtoi pyetje subjektit të rivlerësimit mbi arsyet e shitjes në vitin 2017 të mjetit në vlerën 1,700 euro, më të lartë se vlera e blerjes prej 990 euro, nëse ishin kryer shërbime mirëmbajtje shtesë dhe cila ishte gjendja motorike, xhenerike dhe fizike mjetit në kohën e shitjes. Në kthim përgjigje subjekti i rivlerësimit përgjigjet se: “*... arsyeja e shitjes së automjetit në shumën prej 1,700 euro, ka të bëjë me faktin se gjatë gjithë periudhës së përdorimit të këtij automjeti, janë kryer shërbime të mirëmbajtjes së zakonshme, si ndërrimi i vajrave, filtrave, riparimi dhe lyerja e disa pjesëve të dëmtuara. Theksoj se gjendja motorike, xhenerike dhe fizike e automjetit në momentin e shitjes ka qenë shumë e mirë pasi siç e shpjegova më lart, shërbimet e mirëmbajtjes kanë qenë të vazhdueshme dhe mjeti nuk ka paraqitur defekte të rënda. Duke parë edhe dakordësinë e blerësit, kam kryer shitjen e këtij automjeti në vlerën e mësipërme*”.

Analiza e të ardhurave, të cilat janë deklaruar si burim për krijimin e pasurisë objekt rivlerësimi

25. Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* se për blerjen e mjetit me targa *** kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet nga puna si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës .

26. Gjatë hetimit, i pyetur⁷ nga Komisioni, lidhur me kreditë e marra prej ti dhe bashkëshortes, subjekti shpjegon se: “*Në datën 1.7.2014 kam lidhur kontratë kredie bankare me ‘RFZ’ për marrjen e një kredie bankare në shumën prej 364,000 lekësh. Kjo kredi është marrë për qëllime konsumatore dhe një pjesë është përdorur për blerjen e automjetit tip ‘Ford Focus’, me targa ***, në shkurt të vitit 2015, ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar nga ana ime për blerje të ndryshme.*” Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve kopje të kontratës bankare të datës 1.7.2014, me

²Shkresë nr.*** prot., datë 21.10.2010, e DPPDDR-së.

³Subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting*, vërtetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me të cilën vërtetohet se prej shtatorit të vitit 2008 deri në 6.6.2015 subjekti ka ushtruar funksionin e oficerit të policisë gjyqësore.

⁴Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2020.

⁵Subjekti ka paguar vlerën 34,000 lekë detyrime fiskale për regjistrimin e mjetit të cilat i janë përlllogaritur bazuar në vlerën e zhdoganimit 171,693 lekë

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2020, e AMF-së.

⁷Shihni përgjigje 7 pyetësor nr. 2.

palë kredimarrëse Arian Xhaferraj dhe kredidhënës “RFZ”. Shuma e kredisë është 364,000 lekë me qëllim “arsye personale”.

27. Lidhur me burimin e krijimit për mjetin me targa *** të deklaruar sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar dy burime të ndryshme për krijimin e kësaj pasurie, ku në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, deklarohet të ardhurat nga kursimet nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Durrës dhe gjatë hetimit shpjegon se pjesërisht destinacioni i përdorimit të kredisë së marrë në datën 1.7.2014, në shumën 364,000 lekë, ka shërbyer për blerjen e automjetit me targa ***.

28. Në *statement* bankar të “RFZ”⁸ rezulton se kredia është disbursuar në datën 2.7.2014 dhe se vlera 240,866 lekë është përdorur për shlyerje kredie të hapur më herët, ndërsa pjesa e mbetur rreth 125,000 lekë rezulton e tërhequr në datat 3.7.2014 dhe 7.7.2014. Ndërsa data e blerjes së automjetit është më 16.1.2015, pra, rreth 7 muaj pas datës së çeljes së kredisë. Në lidhje me diferencën kohore ndërmjet shitjes dhe blerjes të konstatuar sa më sipër nuk përcillen nga subjekti shpjegime të mëtejshme. Referuar përmbajtje së kontratës së kredisë gjatë hetimit, nuk u arrit të provohet se kjo kredi ishte përdorur për blerjen e automjetit.

29. Komisioni, në vijim të analizës sa më sipër, nuk arriti të evidentonte pagesën e tatimit për diferencën e çmimit të blerjes (990 euro) me çmimin e shitjes (1,700 euro) të automjetit të subjektit.

30. Referuar analizës së dokumentacionit të administruar në dosjen hetimore të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar qëndrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁹, në analizën financiare të hartuar për subjektin është përfshirë si e ardhur nga shitja e automjetit tip “Ford Focus”, me targa ***, vlera e blerjes së tij prej 990 euro dhe jo vlera e deklaruar nga subjekti prej 1,700 euro. Tashmë në jurisprudencën e Kolegjit është konsoliduar qëndrimi për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve, për të cilin nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor, si e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

31. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2015 dhe në DIPP-në e vitit 2015, në rubrikën *përbërja familjare e zyrtarit sipas certifikatës së gjendjes civile* ka deklaruar përbërje familjare me nënën E.XH dhe babain Sh.Xh. Në përgjigje të pyetësorit standard, lidhur me ndryshimet e përbërjes familjare dhe adresat e banimit ku ka jetuar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “*Nga viti 2015 viti i marrjes së detyrës deri në qershor 2019 kam jetuar me bashkëshorten, vajzën time, si dhe me dy prindërit e mi*”. I pyetur nga Komisioni mbi ndryshimet kronologjike që kanë ndodhur në gjendjen civile subjekti shpjegon se *në vitin 2016 ka jetuar me bashkëshorten, vajzën dhe prindërit dhe pas muajit qershor të vitit 2019 dhe në vitin 2020, jeton me bashkëshorten dhe vajzën.*

32. Subjekti i bashkëlidh deklarimeve: certifikatë familjare për periudhën 1.6.2015 – 12.10.2016, në të cilën rezulton në përbërje familjare së bashku me prindërit, certifikatë martesë nga e cila rezulton se ka lidhur martesë me shtetase O.M në datën 12.10.2016; si dhe certifikatë lindje të vajzës së mitur E.Xh lindur më 22.10.2016.

Në analizë të pikave 13 dhe 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: “13. “*Person i lidhur*” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.

“14. “*Persona të tjerë të lidhur*” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin

⁸Shkresë nr.*** prot., datë 17.12.2020.

⁹Vendim nr. ***, datë 22.5.2019; vendim nr. ***, datë 2.12.2019.

publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

Trupi gjykues çmon se, nisur nga fakti që prindërit e subjektit kanë bashkëjetuar me subjektin dhe kanë pasur një interes pasuror, mbulimin së bashku të shpenzimeve, konsiderohen persona të tjerë të lidhur dhe Komisioni kreu hetim edhe për ta¹⁰.

33. Në vijim të hetimit për automjetin me targa ***, Komisioni hartoi analizën financiare të mëposhtme deri në datën e blerjes më 16.1.2015 dhe vlerë blerje 990 euro plus vlerën e zhdoganimit prej 34,400 lekësh, me burim të ardhurat nga paga si OPGJ, duke përfshirë edhe prindërit e tij në analizë, pasi subjekti ka deklaruar se ka jetuar bashkë me ta.

Analiza financiare	shtator 2008 - dhjetor 2014 (vlerat në lekë)
Të ardhura nga paga si OPGJ, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës	3 885 349
Të ardhurat e nënës së subjektit	3 829 400
Të ardhurat e babait të subjektit	1 751 652
Të ardhura nga interesat bankare	438 031
Shpenzime jetese për 3 anëtarë	2 867 910
Shpenzime udhëtimi	275 589
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	- 931 690
Kredi e marrë në “RFZ”	1 053 736
Shpenzime për shlyerjen e kredive në “RFZ”	1 008 266
Blerja e automjetit me targa ***	136 274
Rezultati financiar	7 601 819

34. Referuar analizës sa më sipër, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin me burim të ardhura të ligjshme.

35. Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi për shkak të funksionit të tij si në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioni iu drejtua Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Durrës, nëse nga subjekti i rivlerësimit shtetasi L.K është hetuar në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës/veprave penale, është thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dëshmitar, i dëmtuar akuzues, viktimë në procedime apo kallëzime të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Prokuroria pranë

¹⁰Nga konsultimi i Komisionit me të dhënat e arkivës dixhitale të pasurive të paluajtshme rezulton se në emër të E dhe Sh.Xh figuron pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. *, f. ***, apartament në qytetin e Durrësit me sipërfaqe 74.02 m² në adresë “**** regjistruar në 26.11.2012”. Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, në analizë të provave të administruara nga organet e vetëqeverisjes vendore, institucione të tjera e pyetësorët e subjektit, rezultoi e provuar se prindërit e subjektit janë pronar të pasurisë sa më sipër. Nga korrespondenca me QKB-së¹⁰ informohemi se nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetase E.Xh rezulton aksionere në shoqërinë “****”, me 70 aksione ose 0,00041% të aksioneve të shoqërisë sipas Urdhrit të Ministrisë së Financave, datë 30.5.2008¹⁰. Ndërsa për shtetasin Sh.Xh, babai i subjektit rezulton se ai ka qenë anëtar i këshillit mbikëqyrës në shoqërinë “****” sh.p.k. me NIPT ***. Referuar ekstraktit historik bashkëlidhur shkresës rezulton se shtetasi Sh.Xh është bërë anëtar i këshillit mbikëqyrës në datë 25.10.2004 dhe është larguar në datë 17.02.2009. Aktualisht kjo shoqëri referuar QKB online rezulton e çregjistruar. Gjithashtu, QKB-ë informon Komisionin se shtetasi Sh.Xh figuron të ketë qenë administrator dhe përfaqësues ligjor në shoqërinë “****” sh.a. me NIPT *** themeluar në datën 24.7.2002, me objekt të aktivitetit “import eksport, përpunimin, transportim dhe tregtim me shumicë e pakicë i naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me status çregjistruar më 11.12.2009. Nga të dhënat e institucioneve financiare për babanë e subjektit të rivlerësimit rezultoi se në “Alpha Bank”¹⁰ i është transferuar shuma 7,200 lekë me bazë mujore nga data 4.3.2009, me përshkrim “**** për Sh.Xh anëtar i këshillit mbikëqyrës” deri më 15.3.2013. Ndërsa nga korrespondenca me DTP¹⁰s-ë nuk konfirmohet pagesa e detyrimeve tatimore gjatë periudhës 2002 – 2013, për të ardhurat nga këto shoqëri tregtare. Referuar shkresës së tyre, ky shtetas nuk është subjekt i *** dhe nuk ka të dhëna për historik të punonjësit. Komisioni në analizën financiare të kryer prej tij, nuk ka përfshirë të ardhurat e përfutuara nga shoqëritë tregtare pasi nuk u arrit të provohej pagesa e detyrimeve tatimore dhe sepse gjatë të njëjtës periudhë kohe rezultoi se babai i subjektit përfitonte pension pleqërie nga muaji gusht i vitit 2001.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë informon¹¹ se nga verifikimi i bërë në sistemin kompjuterik në të cilin administrohen hedhja e të dhënave për personat e dëmtuar dhe të kallëzuar, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të këtë hetuar çështje me personat e mësipërm.

36. Në konkluzion të sa më sipër, nga hetimi Komisionit, rezultoi se për automjetin me targa ***, subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për të blerë me të ardhura të ligjshme automjetin tip “Ford Focus”, me targa ***, në datën 16.1.2015. Subjekti ka pasaktësi në deklaram për burimin e krijimit të automjetit, pasi gjatë procesit të rivlerësimit deklaroi si burim kredinë konsumatore në “RFZ”, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015 deklaroi burim pagat si oficer i policisë gjyqësore.

37. Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit, i kërkoi subjektit shpjegime mbi konstatimet sa më sipër.

Qëndrimi i subjektit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore

38. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, lidhur me konstatimet e lartpërmendura, subjekti depozitoi shpjegimet, si vijojnë: “...*automjeti tip ‘Ford Focus’, me numër shasie *** është zhdoganuar në Degën e Doganës Durrës prej meje sipas deklaratës doganore ***, datë 27.1.2015. Vlera e blerjes së automjetit në Itali është 990 euro (ose ekuivalentja në shumën 136.274 lekë). Kosto totale për sjelljen e mjetit në Durrës dhe zhdoganimin e tij është në vlerën 202,333 lekë, sikurse e kam sqaruar edhe në përgjigjen e pyetjes nr. 4 të pyetësorit nr. 2. Në përfundim të këtij konstatimi, vlerësoj se nuk e kam shitur më shumë se kosto e blerjes automjetin tip ‘Ford Focus’ dhe në këto kushte nuk kam patur detyrimin për të paguar tatimin në burim në lidhje me diferencën e dy çmimeve. Në lidhje me faktin se kam deklaruar dy burime të ndryshme për krijimin e kësaj pasurie. Sqaroj Komisionin se çmimi i blerjes për këtë automjet ka si burim krijimi atë të deklaruar si në DIPP-në e vitit 2015 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ndërkohë përballimi i transportit dhe TVSH-së për zhdoganimin e mjetit ka patur si burim edhe kredinë e marrë pranë RFZ sha... Vlerësoj se kam deklaruar dy burime të ndryshme krijimi për dy shuma të ndryshme të shpenzuara prej meje...”.*

39. Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit parashtroi dhe mbajti të njëjtin qëndrim me atë gjatë hetimit lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, vlerës së shitjes së mjetit me targa ***.

Vlerësimi i Komisionit

40. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimi i subjektit është bindës i bazuar mbi prova në lidhje me pagesën e TVSH-së, në vlerën 34,337 lekë mbi automjetin, e cila rezultoi nga deklarata e zhdoganimit (IM4). Ndërsa në lidhje me shpenzime transporti të kërkuara nga subjekti si pjesë e vlerës së automjetit në shumën 31,722 lekë, kjo nuk gjendet në praktikën e Komisionit¹². Shpenzimet e subjekti për mirëmbajtjen dhe të tjera, për automjetin, janë vendosur në analizën financiare, si shpenzime të kryera në vitin përkatës. Në përfundim të hetimit administrativ, trupi gjykues çmoi se nuk ka pasur problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri, deklaramet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara dhe subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e tij.

2. Llogari rrjedhëse në “RFZ”, në shumën 650,245.7 lekë. Pjesa takuese: 100%.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2021, e Prokurorisë së Rrethit Vlorë.

¹²Në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 3 e tij përcakton se: “Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

41. Si burim të krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kursime nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*¹³ dokumentacionin¹⁴ justifikues ligjor.

42. Në vijim të hetimit të Komisionit për këtë pasuri, “RFZ”¹⁵ informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë klientë i bankës me numër personal ***, mbyllur prej korrikut të vitit 2019. Në datën e deklaramit në deklaratën *Vetting* më 26.1.2017, gjendja e llogarisë në “RFZ” është në vlerën 650,245.7 lekë. Kjo shumë është me burim të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit.

43. Komisioni, në konkluzion të dokumentacionit të administruar, vlerëson se nuk paraqiten problematika lidhur me këtë pasuri dhe deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me informacion dhe dokumentacionin e rezultuar gjatë hetimit të Komisionit, të përcjellë nga “RFZ”¹⁶.

3. Depozitë me afat në “RFZ”, në shumën 345,000 lekë

44. Subjekti deklaron si burim për krijimin e kësaj pasurie kursime nga paga si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *Vetting*¹⁷ dokumentacionin mbi të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e depozitës.

45. Nga hetimi Komisionit për këtë pasuri, “RFZ”¹⁸ informon se në datën 29.12.2016 subjekti i rivlerësimit ka hapur depozitë kursimi me nr. *** me afat 6-mujor dhe vlerë 345,000 lekë. Rezultoi se kjo depozitë është krijuar nga gjendja 885,100 lekë e krijuar në llogarinë e pagës, në datën 29.12.2016, kur është çelur depozita. Ndërsa vlera 885,100 lekë është krijuar nga transferimi i vlerës së pagës së subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2016 dhe nga depozitimi i vlerës 600,000 lekë prej subjektit në datën 18.3.2016.

46. Në vijim të konstatimit sa më sipër, i pyetur nga Komisioni¹⁹ mbi burimin e krijimit të vlerës 600,000 lekë të derdhur *cash* në “RFZ”, në datën 18.3.2016, subjekti ka shpjeguar se: “...në datën 18.3.2016, nga shuma e gjendjes *cash* të mbetur tashmë, kam depozituar në bankë, në llogari rrjedhëse shumë prej 600.000 lekësh... në datën 29.12.2016 në ‘Credins Bank’ kam hapur një llogari depozite me afat 6-mujor, ku kam depozituar shumë prej 345.000 lekësh. Burim krijimi për këtë shumë kanë shërbyer kursimet e mia nga paga si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016. Kontrata e depozitës nuk është rinovuar sërish. ...”.

47. Sa më sipër, nga analiza financiare, rezulton se gjendja e kursimeve *cash* të deklaruara në DIPP-në në datën 31.12.2015 është në total 770,000 lekë, pra, e mjaftueshme për depozitimin e vlerës 600,000 lekë në bankë. Megjithatë, duke u mbështetur në praktikën e Komisionit, nuk mund të konsiderohet si burim krijimi gjendja *cash* në fund të vitit 2015, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 pakësim të gjendjes së kursimeve *cash*, e cila është përdorur si burim për këtë depozitim në bankë.

¹³Shkresë e datës *** e Prokurorisë Durrës, Ankes *** dosja e ILDKPKI-së.

¹⁴Vërtetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me të cilën vërtetohet se prej shtatorit të vitit 2008 deri në 6.6.2015 subjekti ka ushtruar funksionin e oficerit të policisë gjyqësore; vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, të “RFZ”, me anë të së cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit pranë kësaj banke ka llogari rrjedhëse në lekë me nr. ****, hapur në datën 1.10.2008, gjendje e disponueshme e llogarisë në datën 23.1.2017 është 650,245.70 lekë.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2020.

¹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2020.

¹⁷Ankes *** dosja e ILDKPKI-së; vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me anë të së cilit vërtetohet se prej datës 1.12.2015 ka përfituar shumë 429,890 lekë dhe për periudhën janar 2016 – 31.12.2016 ka përfituar të ardhura *neto* në shumë 1,392,544 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, të “RFZ”, me anë të së cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit pranë kësaj banke ka depozitë me afat me numër ***, hapur në datën 29.12.2016 gjendja e disponueshme e depozitës në datën 23.01.2017 është 345,000 lekë; kontratë depozite në “RFZ”, me afat të lidhur në datën 29.12.2016, në të cilën shuma e investuar është 345,000 lekë me afat maturimi 6-mujor.

¹⁸Shkresë nr.*** prot., datë 17.12.2020.

¹⁹Pyetësori nr. 2, përgjigja nr. 5.

48. Komisioni, gjithashtu, hetoi mbi mundësinë e krijimit të vlerës 600,000 lekë nga të ardhurat e tij nga paga gjatë periudhës 1.1.2016 – 17.03.2016 dhe rezultoi se kjo shumë nuk mund të jetë krijuar nga tërheqjet e bëra nga subjekti në këtë llogari page, pasi vlera totale e tërheqjeve gjatë kësaj periudhe është rreth 208,000 lekë.

49. Në konkluzion si më lart referuar dhe analizuar, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm dhe në mënyrë ezauruese se depozitimi i vlerës 600,000 lekë, ka burim gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruar në DIPP-të vjetore. Subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e vlerës 600,000 lekë me të ardhura të ligjshme.

50. Komisioni, mbi konstatimet sa më sipër bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore

51. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit në funksion të barrës së provës, depozitoi në Komision shpjegimet si vijojnë: “...sqsaroj se depozita me afat me numër *** hapur në datën 29.12.2016 ka si burim krijimi atë të deklaruar prej meje si në DIPP-në e vitit 2016 ashtu edhe në deklaratën Vetting, të ardhurat nga kursimet nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në këtë llogari rrjedhëse është hedhur shuma prej 600,000 lekë në datën 18.3.2016 që ka si burim krijimi atë të deklaruar në deklaratën Vetting, kursime nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga kjo datë dhe deri në momentin e krijimit të depozitës, pra, më 29.12.2016 llogaria rrjedhëse ka qenë me balancë më shumë se 500,000 lekë, çka do të thotë se depozita me afat e krijuar ka si burim krijimi atë të deklaruar prej meje si DIPP-në e vitit 2016 ashtu edhe në Deklaratën Vetting, të ardhurat nga kursimet nga paga si prokuror për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016. Vlerësoj se Komisioni nuk duhet të analizonte derdhjen e kursimeve nga paga si oficer i policisë gjyqësore në shumën 600,000 lekë, pasi sikurse e shpjegova, kjo depozitë e krijuar nuk lidhet me derdhjen e datës 18.3.2016. Në këto kushte, vlerësoj se kam provuar bindshëm se depozitimi i vlerës prej 600,000 lekë vjen nga pakësimi i gjendjes së kursimeve që unë disponoja nga periudha para fillimit të detyrës, sikurse e kam deklaruar qartësisht në Deklaratën Vetting dhe gjatë përgjigjeve të dhëna gjatë hetimit administrativ. Në këtë aspekt, çmoj të sjell në vëmendje, gjithashtu se një qëndrim i tillë konfirmohet dhe në dy vendimet e fundit të Kolegjit²⁰ dhe qëndrimin e mbajtur prej tij²¹ për raste të tilla”.

52. Lidhur me depozitimin e shumës prej 600,000 lekësh në datën 18.3.2016, subjekti në seancë dëgjimore parashtroi dhe mbajti të njëjtin qëndrim me atë gjatë hetimit duke rikthësuar se: “Në deklaratën Vetting e kam sqaruar këtë fakt më pas në deklaratën periodike ka qenë një harresë mosdeklarimi i këtij fakti duke qenë se tashme mendoja se ishte ezauruar kjo pjesë duke qenë se unë e kisha sqaruar në deklaratën Vetting faktin nga buronin. Mendoj që Komisioni duhet ta marrë në konsideratë këtë shumë në analizën përfundimtare për shkak se burimi i saj është deklaruar saktësisht në deklaratën Vetting, si në hapjen e llogarisë dhe depozitimin e saj në llogarinë rrjedhëse”.

Vlerësimi i trupit gjykues

53. Komisioni, duke analizuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti shpjegon bindshëm se burimi i derdhjes *cash* të shumës 600,000 lekë janë kursimet e tij nga paga si OPGJ, deklarim të cilin e ka bërë edhe në deklaratën Vetting, ku deklaroi se gjendja e llogarisë në “RFZ” është me burim pagën e tij si OPGJ-ë, por pranon se ka qenë edhe pasaktësi ose harresë prej tij për mosdeklarimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2016 në DIPP e vitit, ku të deklarohet depozitimi i vlerës së mësipërme në sistemin bankar. Duke qenë se vlera e kursimeve në fillim të vitit 2016, nga analiza e Komisionit rezultoi të jetë 770,000 lekë, kjo

²⁰Vendimin e Kolegjit nr. ***, datë 1.7.2020, për JR (A.Z); vendimi nr. ***, datë 24.11.2021.

²¹ Shihni vendimet e Kolegjit: nr. *** datë 28.07.2021 - http://kpa.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendimi_L.

H_ anonimizuar.pdf; nr. *** (JR) datë 23.10.2020 - [http://kpa.al/-content/uploads/2020/12/Vendimi-F.-V.-i-anonimizuar-](http://kpa.al/-content/uploads/2020/12/Vendimi-F.-V.-i-anonimizuar-variantiok.pdf)

variantiok.pdf; nr. 25/2021 (JR) datë 29.07.2021 - http://kpa.al/wpcontent/uploads/2021/11/Vendim_A._Y._anonimizuar.pdf.

sjell mundësi krijimi nga subjekti për vlerën 600,000 lekë të depozituar në “RFZ”. Ndërsa praktika e Komisionit në analizimin e gjendjes *cash* bazohet në deklaratat vjetore. Në përfundim të hetimit administrativ, trupë gjykues çmoi se nuk ka pasur problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri dhe deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

4. Gjendje *cash* në shumën 100,000 lekë

54. Subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë kursime nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016.

55. Subjekti në Deklaratën para Fillimit të Detyrës të vitit 2015 ka deklaruar se: *“Gjendje cash në shumën 750,000 lekë të kursyera nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Pjesa takuese: 100%”*.

56. Në DIPP-ë periodike të viteve 2015 – 2020 ka deklaruar si vijon: (a) në DIPP-në e vitit 2015 subjekti deklaroi se: *“Pakësuar gjendja cash në shumën prej 100,000 lekë. Kursime nga paga për periudhën 1.6.2015 – 31.12.2015, në shumën 120,000 leke”*; (b) në DIPP-në të vitit 2016 subjekti deklaroi se: *“Shtuar gjendje cash në shumën prej 100,000 lekë kursime nga paga si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016”*; (c) në DIPP-në e vitit 2017 subjekti deklaroi se: *“Gjendje cash në vlerën 100,000 lekësh, burimi i krijimit nga të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e kabinetit dentar ***, për vitin 2017.*

57. Subjekti i pyetur nga Komisioni²², mbi deklarinimin e likuiditeteve në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat e interesave private periodike, shpjegon se: *“Në lidhje me totalin e kursimeve të deklaruara nga ana ime në deklaratën *Vetting*... sqaroj se kjo shumë është krijuar nga të ardhurat e mia të krijuara përpara fillimisht të detyrës të cilat kanë qenë kursime nga paga si oficer i policisë gjyqësore si dhe të ardhurat e krijuara nga kursimet si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, në deklaratën e të ardhurave dhe interesave private përpara marrjes së detyrës, kam deklaruar gjendje cash, në shumën prej 750.000 lekësh, kursime të krijuara nga puna ime si oficer i policisë gjyqësore për periudhën 2008 – 2015. Përgjatë vitit 2015, deri në datën 31.12.2015, nga shuma e mësipërme kam shpenzuar 100.000 lekë duke u pakësuar gjendja cash në këtë shumë. Këtë fakt e kam deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015. Po kështu, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, kam kursyer shumën prej 100.000 lekësh, e cila është shtuar si gjendje kesh. Burim krijimi për këtë shumë kanë shërbyer sërish kursimet e mia nga paga, dietat dhe shpërblimet si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016”*.

58. Subjekti vijon me shpjegimet e tij në lidhje me gjendjen *cash* të çdo fund viti: *“Kursimet cash të deklaruara ndër vite kanë qenë: (a) para fillimit të detyrës deklaruar gjendje cash 750,000 lekë. Nga kjo shumë, në datën 18.3.2016, është depozituar në llogari rrjedhëse pranë ‘RFZ, shuma prej 600.000 lekësh; (b) viti 2015 pakësuar gjendja cash, në shumën prej 100,000 lekësh; (c) vitit 2016 shtuar gjendja cash në shumën prej 300,000 lekësh (së bashku me të ardhurat e bashkëshortes ndër vite); (ç) viti 2017 shtuar gjendja cash në shumën prej 100,000 lekësh”*.

59. Subjekti bashkëlidh me shpjegimet shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara nga paga si oficer i policisë gjyqësore për periudhën 2008 – 2015, si dhe shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara nga paga si prokuror për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016.

60. Në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar në Deklaratën Para Fillimit të Detyrës të vitit 2015, në vlerë 750 000 lekë, me burim të deklaruar: *“... të kursyera nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”* Komisioni hartoi

²²Përgjigje nr. 5, pyetësori nr. 2.

analizën financiare për mundësinë e krijimit të vlerës së kursimeve para detyre, si në tabelën vijuese:

Analiza financiare	1.9.2008 – 30.5.2015 (vlerat në lekë)
Të ardhura nga paga si OPGj	4 187 474
Të ardhurat e babait të subjektit	1 876 770
Të ardhurat e nënës së subjektit	1 483 631
Te ardhura nga interesat bankare	455 432
Shpenzime jetese për 3 anëtarë	3 204 324
Shpenzime udhëtimi	284 261
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë dhe <i>cash</i>	- 1 520 405
Kredi e marrë në “RFZ”	1 122 536
Shpenzime për shlyerjen e kredive në “RFZ”	1 060 018
Blerja e automjetit me targa ***	136 274
Rezultati financiar	5 961 372

61. Referuar analizës financiare sa më sipër rezulton se subjekti ka pasur mundësi të krijojë gjendjen *cash* para fillimit të detyrës në vlerën 750,000 lekë me të ardhura të ligjshme. Në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është bazuar në deklaratimet e gjendjes *cash* në DIPP-të periodike, pasi përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës të kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit. Në rastet e ndryshimit të deklaratimit të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit²³, referenca e Komisionit për kryerjen e analizës financiare u bazua në deklaratimet vjetore të tij dhe shpjegimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit nuk janë konsideruar në analizën financiare të Komisionit. Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁴, e cila orienton Komisionit se *...në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit në zbatim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe së bashku me deklaratën Vetting përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit .*

62. Sa më sipër, Komisioni në konkluzion konstaton se nuk përputhet gjendja e kursimeve *cash*, e cila rezulton nga akumulimi i deklaratimeve në DIPP-të për vitet 2015-2016 të subjektit, me gjendjen e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Ka mospërputhje të vlerës së gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* prej 100,000 lekësh me gjendjen *cash* nga deklaratimet periodike vjetore (DIPP-të), ku rezulton në vlerën 870,000 lekë në fund të vitit 2016. Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duke deklaruar vetëm shtesën e kursimeve të vitit 2016 dhe jo gjendjen totale të tyre në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë.

63. Mbi konstatimet sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me qëllim për të parashtruar shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

²³Si p.sh. deklarimi në pyetësor nr. 2, mbi kursimet e vitit 2016 ku deklaror ndryshe nga DIPP/2016, duke shtuar “viti 2016 shtuar gjendja *cash* në shumën prej 300,000 lekësh (së bashku me të ardhurat e bashkëshortes ndër vite), ndërsa në DIPP/2016 deklaror “shtuar gjendje *cash* në shumën prej 100,000 lekë, kursime nga paga si prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016” dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësorin nr. 2, për gjendjen *cash* para fillimit të detyrës “para fillimit të detyrës deklaruar gjendje *cash* në vlerën 750.000 lekë. Nga kjo shumë, në datën 18.3.2016 është depozituar në llogari rrjedhëse pranë ‘RFZ, shuma prej 600.000 lekësh” me deklarimin në deklaratën para fillimit të detyrës 2015 “gjendje *cash* në shumën 750,000 lekë të kursyera nga paga si OPGJ në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”

²⁴ Vendimet nr. ***/2018; ***/2018; ***/2018; ***/2018; ***/2018; ***/2019; ***/2019.

Qëndrimi i subjektit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore

64. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti depozitoi në Komision, prapësimet si vijon: “Në deklaratën Vetting unë kam deklaruar gjendjen e likuiditeteve në momentin e dorëzimit të deklaratës. Nisur nga fakti se deklarata Vetting ishte dorëzuar përpara DIPP-së për vitin 2016, në këtë të fundit kam deklaruar vetëm shtesën 100,000 lekë që kisha deklaruar nga deklarata Vetting dhe që në fakt ka qenë gjendja reale e kursimeve në cash të disponuara. Pranoj që ka qenë një pasaktësi plotësimi i DIPP-së për vitin 2016, shkaktuar nga harresa e mosdeklarimit të gjendjes së llogarisë rrjedhëse në ‘RFZ, në shumën 650,118 lekë me burim krijimi pakësimin e gjendjes së kursimeve cash, fakt i deklaruar qartazi nga ana ime në deklaratën Vetting. Nuk kam pasur qëllim mosdeklarimin e pakësimin, për sa kohë e kam shprehur në deklaratën Vetting që disponoj gjendje vetëm 100,000 lekë dhe që shtesat në bankë ishin krijuar me pakësimin e gjendjes cash. Vlerësoj se pavarësisht se në DIPP-në e vitit 2016 ka një pasaktësi, për efekt të procesit të rivlerësimit nga ana ime është deklaruar qartazi dhe para se të dorëzohej DIPP-ja e vitit 2016 me këtë pasaktësi në deklarim, që krijimi i gjendjes së llogarisë rrjedhëse është me burim kursimet nga paga si oficer i policisë gjyqësore. Si përfundim, në këtë situatë kur kam deklaruar saktësisht në deklaratën Vetting pakësimin e kursimeve cash me 600,000 lekë, por në DIPP nuk kam deklaruar pakësimet për shkak të mosdeklarimit të gjendjes së llogarisë rrjedhëse në datën 31.12.2016, vlerësoj se Komisioni duhet të marri në konsideratë këtë pasaktësi dhe në harmoni edhe me deklaratimet e mia gjatë hetimit administrativ, të përfshijë në analizën financiare gjendjen cash më 31.12.2016, në shumën 270,000 lekë, aq sa realisht mund të provohet me deklaratimet e mia. Megjithatë, qëndrimi im në lidhje me gjendjen e kursimeve cash në fund të vitit 2016 është se kam pasur gjendje të disponueshme vetëm shumën 100,000 lekë. Gjendja cash e deklaruar në deklaratën Vetting.”

Vlerësimi i Komisionit

65. Në funksion të barrës së provës dhe në analizë të shpjegimeve dhe deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe hetimit të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë gjendjen e kursimeve cash në deklaratën Vetting. Pësia e pasaktësive të deklaratimeve periodike në procesin e rivlerësimit të një subjekti është trajtuar në një sërë vendimesh të Kolegjit⁵¹ dhe të Komisionit⁵², nga ku rezulton se ato nuk mund të përbëjnë shkak të veçuar për marrjen e masës disiplinore.

5. Apartament banimi i marrë me qira në qytetin e Vlorës në datën 4.2.2016 me sip. 60.6 m², z. k. *, me vlerë 10,000 lekë/muaj**

66. Deklarimet e subjektit në vite: në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi i marrë me qira në qytetin e Vlorës në datën 4.2.2016 me sip. prej 60.6 m², ZK ***, vlera e qerasë 10,000 lekë në muaj”; në DIPP-në e vitit 2017 ka deklaruar: “Mbaruar kontrata dhe dorëzuar apartament banimi i marrë më parë me qira në qytetin e Vlorës”.

67. Subjekti i bashkëlidh deklaratës së pasurisë Vetting²⁵, kontratë qiraje nr. ***, datë 4.2.2016, me palë qiradhënës shtetasi E.M përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. ***, datë 7.7.2015, nga shtetasi P.M për dhënien me qira të një apartamenti me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Vlorë, kundrejt vlerës së qirasë 10,000 lekë/muaj, me afat 1 vit. Konstatohet nga Komisioni se palët në kontratë nuk kanë parashikuar mënyrë pagese për qiranë mujore nëse do të bëhet cash apo me bankë.

68. I pyetur nga Komisioni²⁶, se ku ka banuar nga marrja e detyrës në qershor të vitit 2015 deri në lidhjen e kontratës së qerasë në datën 4.2.2016 për apartamentin në qytetin e Vlorës, subjekti deklaroi se: “Sqaroh se nga momenti i marrjes së detyrës, qershor të vitit 2015 deri në datën 4.2.2016, unë kam jetuar në banesën e prindërve të mi në qytetin e Durrësit. Kam udhëtuar çdo ditë për të shkuar në punë në qytetin e Vlorës. Gjatë kësaj periudhë rrugën e kam bërë me shtetasin P.A, i cili në atë periudhë punonte si oficer i policisë gjyqësore i Doganave

²⁵Shihni ankes 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶Përgjigje nr. 9, pyetësori nr. 2.

në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, por me banim ishte në qytetin e Durrësit. Në ndonjë rast, sidomos në ditët e gatishmërisë, kam fjetur në hotel në qytetin e Vlorës, duke paguar një shifër të përafërt me 20,000 lekë nata. Sqaroj se nuk kam mundur të administroj një deklaratë noteriale nga ana e shtetasit P.A, pasi në dijeninë time ai ka emigruar jashtë shtetit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.

69. Në vijim të hetimit, Komisioni i drejtoi pyetje subjektit të rivlerësimit për të sqaruar sa më saktësisht se çfarë shpenzimesh mbulonte kjo shumë e deklaruar, si dhe për të specifikuar vlerën totale të saj për vitin 2015 dhe deri në datën e marrjes me qara të apartamentit në vitin 2016. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me sa është pyetur nga Komisioni, shpjegoi se “Sqaroj se lidhur me deklarinë në pyetësinë me nr. 2, shuma së cilës i jam referuar ka qënë 2,000 (dy mijë) lekë të reja dhe jo 20,000 (njëzetë mijë) lekë. Citimi i kësaj shume ka qënë një lapsus (duke e shprehur me lekë të vjetra) gjatë përgjigjes së dhënë nga ana ime pasi realisht shuma e paguar ka qënë 2 000 (dy mijë) lekë të reja për një natë fjetje, shume e cila është paguar nga ana ime gjatë ditëve që kam fjetur në Vlorë në ditët e gatishmërisë. Duke marrë për bazë faktin që kam filluar pune në muajin Qershor 2015 deri në momentin që kam marrë banesën me qera në muajin Shkurt 2016, kam paguar në total për fjetje në hotel gjate ditëve të gatishmërisë shumë prej 32.000 (tridhjetë e dy mijë) lekë të reja, për 16 ditë gatishmërie sipas grafikëve bashkëlidhur”.

70. Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve dokumentacionin²⁷ provues ligjor në të cilin mbështet shpjegimet e tij, si dhe grafikun e gatishmërisë për periudhën qershor 2015 – janar 2016 të Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Komisioni konstaton sipas këtij grafiku se subjekti ka qënë i gatshëm 16 herë gjatë periudhës qershor 2015 – shkurt 2016.

71. Nga konsultimi i Komisionit me ASHK-në online konstatohet se shtetasi E.M është pronar i pasurisë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Vlorë.

72. Lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi për shkak të funksionit të tij si në Prokurorinë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në Prokurorin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioni iu drejtua Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Durrës²⁸, nëse nga subjekti i rivlerësimit shtetasit E.M dhe P.M janë hetuar në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës/veprave penale, janë thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dëshmitar, i dëmtuar akuzues, viktimë në procedime apo kallëzime të hetuara nga subjekti i rivlerësimit dhe informohemi²⁹ se nga verifikimi i bërë në sistemin kompjuterik në të cilin administrohen hedhja e të dhënave për personat e dëmtuar dhe të kallëzuar, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të këtë hetuar çështje me personat e mësipërm. Prokuroria në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës informon se pas verifikimeve elektronike në ZVRPP nuk rezulton se shtetasit për të cilët u kërkuar informacion, subjekti të këtë hetuar materiale hetimore për periudhën shtator 2008 – 6.6.2015, kur ka ushtruar funksionin si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vlerësimi i Komisionit

²⁷Shkresë nr.*** prot., datë 12.7.2021, e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Administrativ Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore “kthim përgjigje” nga e cila rezulton se shtetasi P.A ka qënë punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në funksionin oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën 16.7.2008 – 16.03.2016; shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë “kthim përgjigje” nga e cila rezulton se z. P.A është emëruar oficeri i policisë gjyqësore i policisë doganore, pranë seksionit të Prokurorisë së Rrethit Vlorë në datën 17.7.2008. Në datën 8.1.2010, z. P.A është caktuar oficer i policisë doganore, pranë seksionit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Njësinë e Përbashkët Hetimore. Në datën 3.3.2016, z. P.A lirohet nga detyra me dorëheqje; shkresë me nr. *** prot., datë 16.3.2016, “vendim për lirim nga detyra me dorëheqje” për z. P.A të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Administrativ Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; shkresë nr. ***, prot., datë 8.1.2010, të Prokurorisë së Përgjithshme Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore “për caktimin e oficerëve të policisë gjyqësore pranë seksioneve”, nga e cila rezulton se z. P.A caktohet oficer i policisë doganore, pranë seksionit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Njësinë e Përbashkët Hetimore.

²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2021.

²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2021, Prokuroria e Rrethit Vlorë.

73. Sa më sipër rezultoi se deklaramet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindësi dhe përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni. Trupi gjykues vlerësoi se nuk rezultuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

6. Kontratë qiraje për ambient me sip. 37 m², lidhur në datën 28.6.2015 midis bashkëshortes së subjektit O.Xh (M) dhe shtetasit R.Sh, për ushtrimin e aktivitetit *, vlera e qirasë 10,000 lekë/muaj**

74. Subjekti i bashkëlidh deklaratës së pasurisë *Vetting*³⁰ kontratë nr. ***, datë 28.6.2015 me palë qiradhënës shtetasin R.Sh dhe qiramarrës bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit O.M. Certifikatën regjistrimi për personin e tatueshëm “****” me NIPT ***.

75. Në DIPP-në të vitit 2018 subjekti ka deklaruar: “*Mbaruar kontrata e qerasë me shtetasin R.Sh për ambientin e marrë me qira nga bashkëshortja në vitin 2015 dhe rilidhur kontratë e re qiraje me nr. ****, datë 19.9.2018, për një afat 3-vjeçar me qira mujore 10,000 lekë*”.

76. Rezulton se me kontratë qiraje nr. ***, datë 28.6.2015, shtetasi R.Sh jep me qira pasurinë me sip. 38 m² bashkëshortes së subjektit për një afat 3-vjeçar, në vlerën 10,000 lekë/muaj me destinacion përdorimi të pasurisë klinike dentare.

77. Nga konsultimi i Komisionit me ASHK-në *online* rezulton se shtetasi R.Sh është pronar pasurisë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 68 m², Durrës.

78. Referuar korrespondencës së Komisionit me QKB³¹-në informohemi se shtetasja O.M (bashkëshortja e subjektit) figuron e regjistruar si person fizik i pajisur me NIPT *** dhe bashkëlidh ekstraktin historik të personit fizik nga ku rezulton se bashkëshortja e subjektit është regjistruar si person fizik në datën 1.9.2015, për ushtrimin e aktivitetit “****” dhe është me status aktiv.

Vlerësimi i Komisionit

79. Në përfundim të hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri dhe deklaramet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

7. Deklarimi i detyrimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *Vetting*

80. Kredi bankare në “RFZ”, me qëllim konsumator e lidhur në datën 1.7.2014, në vlerën 364,000 lekë, data e fillimit më 2.4.2014, më kohëzgjatje 48 muaj, interesi nominal i kontratës së kredisë është Tribor1Y+9.6%, kësti 9,651.43 lekë/muaj. Shuma e mbetur pa shlyer 158,834.86 lekë.

81. Subjekti në Deklaratën Para Fillimit të Detyrës në vitin 2015 deklaruar: “*Kredi Bankare në ‘RFZ, me qëllim konsumator e lidhur në datën 1.7.2014, në vlerë 364,000 lekë, data e fillimit më 2.4.2017, më kohëzgjatje 48 muaj kësti mujor 9,881.23 lekë. Shuma e shlyer deri në datën e plotësimit të deklaratës më 22.6.2015, është në vlerën 287,066 lekë*”. Në DIPP-të për vitet 2015 dhe 2016 për kredinë bankare, subjekti ka deklaruar: “*Në DIPP-në e vitit 2015 -kredi bankare në ‘RFZ me qëllim konsumator e lidhur në datën 1.7.2014, në vlerë 364,000 lekë data e fillimit më 2.4.2017, më kohëzgjatje 48 muaj kësti. Shuma e mbetur pa shlyer deri në datën 31.12.2015, është 256,591.01 lekë; në DIPP-në vitit 2016 - kredi bankare në ‘RFZ me qëllim konsumator e lidhur në datën 1.7.2014, në vlerën 364,000 lekë, data e fillimit më 2.4.2017, më kohëzgjatje 48 muaj kësti mujor 9,651.43 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer deri në datën 31.12.2016 është 116,916.84 lekë*”. Deklaramet e subjektit për këtë kredi vazhdojnë edhe në DIPP-të për vitet 2017 dhe 2018, në të cilat deklarohen shumën e mbetur pa shlyer dhe më pas shlyerjen totale të kësaj kredie në vitin 2018.

³⁰Shihni Aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, e QKB-së.

82. “RFZ”³² informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë klientë i bankës me numër personal ***, i cili është aktualisht i mbyllur (me korrik 2019). Gjithashtu, informohemi se pranë kësaj banke subjekti përpara fillimit të detyrës si prokuror, në datën 1.6.2015³³, ka marrë disa kredi. Subjekti depoziton dokumentacionin provues ligjor për marrjen, disbursimin dhe likuidimin e këtyre kredive³⁴.

Vlerësimi i Komisionit

83. Bazuar në verifikimin dhe analizimin e informacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, përgjatë procesit të rivlerësimit rezultoi se deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimi, duket i besueshëm/i vërtetë dhe përputhet me dokumentacionin e rezultuar gjatë hetimit të Komisionit të përcjellë nga “RFZ” dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri. Trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri dhe deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

8. Kontratë huapërdorje, datë 2.9.2015, lidhur midis bashkëshortes O.Xh dhe shtetasit M.Rr për marrjen në huapërdorje pa kundërshpërblim të pajisjeve dentare për ushtrim aktivitet të *** “****”

84. Subjekti i bashkëlidh deklaratës së pasurisë *Vetting*³⁵, kontratë huapërdorje të lidhur në datën 2.9.2015 ndërmjet huadhënësit në përdorim, z. M.Rr dhe huamarrëses në përdorim, shtetases O.M me NIPT ***. Objekti i huapërdorjes dhënia në përdorim e pajisjeve stomatologjike pa kundërshpërblim dhe pa afat. Sipas objektit të kontratës, palët kanë rënë dakord të japin në përdorim, pa kundërshpërblim, pajisjet dentare: poltron dentar tip “****”, vit prodhimi 2003 i përdorur; pajisje dentare për dezinfektim pajisjesh dentare (autoklavë) tip “B-Klas”, prodhim kinez, e përdorur. Në kontratë, palët kanë parashikuar gjithashtu se në rast dokordësie ndërmjet tyre pajisjet e mësipërme do të kalojnë në pronësi të palës huamarrëse. Shitja e këtyre pajisjeve do të bëhet kundrejt shumës prej 230,000 lekësh vlera e poltronit dhe 150,000 lekë vlera e autoklavës.

85. Komisioni, përgjatë hetimit konstaton faktin se pavarësisht se kjo marrëdhënie kontraktore, e cila përfshin personin e tij të lidhur, bashkëshorten, ka lindur përpara lidhjes në martesë ligjore³⁶ dhe është krijuar përgjatë detyrës së subjektit është objekt verifikimi në kuadër të ligjit nr. 84/2016.

86. Në përgjigje të pyetësorit standard, i pyetur nga Komisioni mbi përbërjen familjare, subjekti ka shpjeguar se: “*Përgjatë vitit 2016 kam jetuar me nënën, babain, bashkëshorten dhe vajzën e mitur*”. Referuar periudhës së afërt nga lidhja e kontratës së huapërdorjes datë 2.9.2015 dhe fillimit të bashkëjetesës së deklaruar nga subjekti me shtetasen O.M, Komisioni vlerësoi në analizë të pikës 14, të nenit 3, ligjit nr. 84/2016 në të cilën parashikohet: “14. “*Persona të tjerë*

³²Shkresë nr.*** prot., datë 17.12.2020.

³³Kredi konsumatore në shumën 300,000 lekë të cilën e ka marrë në datën 17.6.2009 dhe mbyllur në datën 30.8.2010 me marrjen e një kredie tjetër në shumën 361,835.50 lekë më pas e shlyer totalisht në datën 2.7.2014; kredi konsumatore në shumën 27,900 lekë të marrë në datën 16.8.2011 dhe të mbyllur në datën 16.08.2013. Prej dokumentacionit bashkëlidhur përgjigjes rezulton se kjo kredi është marrë për blerje telefoni celular pranë “****” sh.p.k.; kredi konsumatore në shumën 364,000 lekë të marrë në datën 2.7.2014 dhe të mbyllur në datën 2.7.2018 me qëllim dhënie kredie “për arsye personale”.

³⁴Vërtetim nr. *** prot., datë 13.7.2021, të “RFZ” nga i cili rezulton se shtetase O.M nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie Kredi Konsumatore pranë “RFZ”; kontratë kredie bankare në “RFZ” datë 16.6.2009 në të cilën Arian Xhaferraj dhe znj.E.Xh bashkëkredimarrëse, merr kredi në shumën 300,000 lekë për një afat 60 mujor me këst mujor 10,509 lekë. Qëllimi i marrjes së kredisë është për arsye Personale; kredi bankare në “RFZ”, datë 27.8.2010, në të cilën Arian Xhaferraj me bashkëkredimarrës E.Xh merr kredi shumën 361,835.5 lekë për një afat 84-mujor me këst mujor 1,417.54 lekë. Qëllimi i marrjes së kredisë është pjesërisht për mbylljen e kredisë së akorduar me kontratën e datë 16.6.2009 dhe pjesa tjetër tepicë kreditore në llogarinë e z. Arian Xhaferraj; kredi e marrë në datën 9.8.2011, nga “RFZ”, në shumën 27,900 lekë me këst mujor 1,417.54 lekë me afat 12-mujor me qëllim blerje mallrash. Në lidhje me këtë kredi subjekti bashkëlidh dhe faturë nga dyqani “****” të datës 9.9.2011, për blerjen e një aparati celular të llojit *** në vlerë 24,900 lekë; kontratë kredie bankare në “RFZ”, datë 1.7.2014, më të cilën z. Arian Xhaferraj merr kredi shumën 364,000 lekë për një afat 48 muaj më këst mujor 10,509 lekë. Qëllimi i marrjes së kredisë është për arsye personale; kontratë shitje nr. ***, datë 3.10.2011, në të cilën z. A.XH shet subjektit të rivlerësimit mjetin “Fiat Punto”, me targa ***, nr. shasje ***, në vlerën 2,000 euro; dokumentacionin e blerjes së automjetit “Ford Focus”, me nr. shasje ***, me targa ***, blerë në vitin 2015.

³⁵Aneks 4/10 i ILDKPKI-së.

³⁶Martesa ligjore sipas certifikatës së martesës është lidhur në datën 12.10.2016.

të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose Komisionerin Publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”, huadhënësi M.Rr konsiderohet person tjetër i lidhur. Komisioni hetoi lidhur me mundësinë dhe aftësinë e dhënies në përdorim të pajisjeve të kabinetit dentar nga shtetasi M.Rr.

87. Në këtë këndvështrim, marrëdhënia kontraktore e huapërdorjes ndërmjet shtetasit M.Rr dhe shtetases O.M është lidhur në kuptim të nenit 901³⁷ të Kodit Civil dhe palët sipas interpretimit të këtij neni dhe në referencë të orientimeve të Kolegjit në vendimmarrje të saj janë në cilësinë e huadhënësit dhe huamarrësit dhe kontrata e huapërdorjes klasifikohet kontratë huaje, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Për sa është analizuar më sipër.

88. Hetimi u krye nisur edhe nga fakte të provuara me shpjegimet e subjektit se njohja³⁸ me shtetasen O.M provohet se ka ndodhur më parë se lidhja e martesës ligjore në datën 12.10.2016, lidhjes në krushqi të subjektit me shtetasin M.Rr dhe marrëdhënies kontraktuale të këtij shtetasi me bashkëshorten e tij të ardhshme, si dhe krijimit të të ardhurave nga përdorimi i sendeve objekt huapërdorje, të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurive të subjektit në të ardhmen.

89. Në vijim të analizës sa më sipër, Komisioni i drejtoi pyetje subjektit të rivlerësimit se në cilat rrethana është njohur ai ose bashkëshortja me shtetasin M.Rr, si dhe nëse janë blerë pas nënshkrimit të kontratës së huapërdorjes në vitin 2015 pajisjet e kabinetit dentar. Në kthim përgjigje subjekti përgjigjet: *“Me shtetasin M.Rr jam njohur para shumë vitesh në qytetin e Durrësit nga shoqëri e përbashkët, por ndër të tjera ky shtetas është edhe bashkëshorti i vajzës së hallës time shtetases A.K. Ky shtetas është me profesion stomatolog dhe që prej vitit 2011 ushtron aktivitetin në qytetin e Durrësit ... Pas lidhjes së kontratës së huapërdorjes në vitin 2015 as unë apo bashkëshortja ime nuk i kemi blerë pajisjet dentare. Bashkëshortja vijon t’i përdorë ato sipas kontratës së huapërdorjes”*. Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve foto të pajisjeve të kabinetit dentar.

90. Në vijim të përgjigjes sa më sipër, Komisioni iu ridrejtoi subjektit të rivlerësimit³⁹ dhe i kërkoi të depozitonte për nevoja të hetimit, dokumentacion provues në formën e kërkuar ligjore, të blerjes së pajisjeve dentare nga shtetasi M.Rr dokumentacion ligjor dhe financiar provues që këto pajisje dentare janë ende në përdorim nga bashkëshortja dhe nuk janë blerë.

90.1 Lidhur me dokumentacionin provues për shtetasin M.Rr: *“M.Rr këto pajisje ai i ka blerë nga shtetasi Dh.K⁴⁰ që sapo kishte mbyllur klinikën dhe në këto kushte ai nuk disponon faturë blerje apo dokumentacion tjetër në lidhje me blerjen e këtyre pajisjeve. Po kështu, nga ky shtetas më është bërë me dije se pajisjet në momentin e blerjes prej tij, kanë qenë të përdorura dhe nisur edhe nga vlera e tyre e vogël... këto pajisje pasi kishin shumë vite që i kishte blerë, nuk disponon faturë në lidhje me blerjen e tyre. Për këtë arsye e kam të pamundur objektivisht t’ju vë në dispozicion kopje të faturës së blerjes apo dokumentacion tjetër që lidhet me blerjen e këtyre pajisjeve nga ana e shtetasit M.Rr. Shtetasi M.Rr vendosi të japë këto pajisje në përdorim pasi kishte porositur pajisje të reja, po të njëjtës markë, por me vit prodhimi të ndryshëm. Për të vërtetuar faktin se ky shtetas ka blerë pajisje dentare të reja, ju vendos në dispozicion faturën tatimore të shitjes nr. ***, nr. serial ***, e datës 19.11.2015, lëshuar nga shoqëria “*** sh.p.k., me NIPT ***. Edhe kjo faturë shitjeje është blerë në emër të individit M.Rr me numrin personal të kartës ID dhe jo NIPT-in e biznesit. Në faturën tatimore të shitjes bashkëlidhur faturës tatimore jepen të dhënat e artikullit të shitur Unit A5 në vlerën totale me TVSH 9,600 euro ... në këto kushte për shkak edhe të*

³⁷Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e palës që ka dhënë sendin.

³⁸Sipas të dhënave të sistemit TIMS për subjektin e rivlerësimit, konstatohet se me shtetasen O.M, subjekti i rivlerësimit ka hyrje-dalje nga territori shqiptar që prej vitit 2012.

³⁹Shihni pyetësorin nr. 5 në dosjen e hetimit.

⁴⁰Subjekti depoziton ekstraktin historik me vulë elektronike.

marrëdhënies me këtë shtetas ai vendosi t'i lërë në përdorim këto pajisje, moment kohor ky përpara se unë dhe bashkëshortja të lidhim martesë ligjore". Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve dokumentacionin⁴¹ provues ligjor në të cilin mbështet deklaratimet sa më sipër.

90.2 Mbi aftësinë blerëse të shtetasit M.Rr: *"Shtetasi M.Rr i ka blerë këto pajisje dentare kohë më vonë pas fillimit të aktivitetit të tij. Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 25.1.2022, konfirmohet se pajisjet dentare u blenë si poltron i dytë për klinikën me qëllim rritjen e kapaciteteve të klinikës. Pasi kishte porositur Unit të Ri dentar për shkak të marrëdhënieve familjare me këtë shtetas, ky poltron është lënë në përdorim prej tij dhe ende sot ne nuk kemi kryer asnjë procedurë tjetër ligjore. Qëllimi i bashkëshortes është blerja e një poltroni të ri dhe me parametra aktual që do t'i përgjigjej shpejtësisë së kryerjes së punës dhe funksioneve shtesë duke u harmonizuar kjo pajisje dhe me pajisje të tjera që mund të nevojiten për kryerjen sa më të mirë të shërbimit. Kjo është edhe arsyeja që ne ende sot nuk e kemi blerë këtë poltron. Për t'iu përgjigjur pyetjes dhe për të vendosur në dispozicion të Komisionit dokumentacion justifikues ligjor që këto pajisje nuk janë blerë, vlerësoj se i vetmi dokumentacion që mund të paraqesë këtë fakt janë pasqyrat financiare të depozituara nga bashkëshortja ndër vite në organet tatimore. Sipas pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, zëri 'amortizim i aktiveve afatgjata' është 0 (zero). Në këtë rast, për sa kohë vetë zëri 'amortizim' është zero tregon se personi fizik i regjistruar në emër të bashkëshortes nuk zotëron asete. Fakti se aktiviteti i bashkëshortes nuk disponon asete dhe nuk ka amortizim, tregon qartë se këto pajisje ende nuk janë blerë nga bashkëshortja. Marrëdhënien e mësipërme, pra atë të huapërdorjes së pajisjeve dentare nga ana e bashkëshortes sime, e kam deklaruar me vërtetësi dhe saktësi në deklaratën Vetting, në përputhje me kërkesat e pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Shtetasi M.Rr ka pasur aftësi financiare për blerjen e këtyre pajisjeve dentare. Deri në momentin që shtetasi M.Rr ka blerë pajisjet dentare, që në dijeninë e tij ka qenë rreth muajve tetor-nëntor të vitit 2013, ai ka pasur të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit në shumën 4,200,000 lekë dhe, për rrjedhojë, edhe aftësinë paguese për të kryer blerjen e pajisjeve të cituara në kontratën e huapërdorjes të datës 2.9.2015".*

91. Subjekti u bashkëlidh shpjegimeve dokumentacionin⁴² ligjor dhe financiar të aktivitetit tregtar me objekt klinikë dentare të personit fizik "****"⁴³.

92. Në vijim të hetimit për këtë pasuri nga korrespondenca me QKB-në⁴⁴ konstatohet se shtetasi M.Rr rezulton i regjistruar si subjekt tregtar me NIPT ***, regjistruar në datën 3.2.2011 me objekt të aktivitetit tregtar stomatolog me vendndodhje në Durrës.

93. Drejtoria Rajonale e Tatimeve për të dhëna tatimore për subjektin tregtar "*****" nga e cila informohemi⁴⁵ se pas verifikimeve të bëra në sistemin informatik tatimor rezulton se shtetasi M.S.Rr është i regjistruar në organin tatimor DRT Durrës si person fizik me NIPT *** DPT bashkëlidh ekstraktin historik të personit fizik "****", deklaratat tatimore mbi të ardhurat

⁴¹Deklarata noteriale me nr. ***, datë 25.1.2022, të shtetasit M.Rr; kopje e noterizuar e faturës tatimore të shitjes me nr. ***, datë 19.11.2015; ekstrakti historik për subjektin Dh.K.

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2022, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës informon se personi fizik "*****" me NIPT *** me objekt aktiviteti "*****" ka pasur xhiroja vjetore për periudhën 2011 -2013 sipas së cilës deklaratën parashikuese të qarkullimit vjetor për vitin 2011 që mban datën 23.1.2011 ka vetëdeklaruar se xhiroja për këtë vit do të ishte në vlerën 1,500,000 lekë. Ndërkohë, po për vitin 2011 nga ana e vetë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore është bërë rivlerësim i xhiros duke e kategorizuar në xhiron me vlerë 2,000,000 – 3,000,000 lekë. Në vitet 2012 dhe 2013, nga shtetasi M.Rr është nënshkruar deklarata parashikuese e qarkullimit vjetor ku është vetëdeklaruar se xhiroja faktike për vitin 2012 ka qenë në vlerën 2,000,000 lekë dhe po për vitin 2013 xhiroja parashikuese e deklaruar është në vlerën 2,000,000 lekë. Blerja e pajisjeve dentare ka si burim krijimi të ardhurat e tij nga biznesi që ushtronte. Bazuar në xhiron e realizuar nga ky subjekt gjatë periudhës 2011 – 2013, rezulton se ka pasur një fitim që sipas Urdhrit të Stomatologut dhe praktikës së Komisionit në vendime të tjera është përlogaritur si 70% e xhiros. Fitimi neto i realizuar vetëm në këto tre vjet, duke marrë në konsideratë xhiron në vlerën 2,000,000 lekë për çdo vit, është 1,400,000 lekë/vit ose 4,200,000 lekë për këto tri vite.

⁴³Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2022, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, si dhe deklaratën noteriale me nr. ***, datë 25.1.2022, të shtetasit M.Rr.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2021, e QKB-së.

⁴⁵Shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2021, e DPT-së.

personale nga vitet 2011 – 2013, deklarata të tatimit të thjeshtuar të fitimit nga vitet 2014 – 2020, vlerat e të cilave janë pasqyruar në tabelën vijuese.

Periudha e deklarimit	Deklarata e tatimit mbi të ardhurat personale biznes i vogël	
	Qarkullimi i deklaruar (vlerat në lekë)	Fitimi <i>neto</i> (vlerat në lekë)
2011	135 419	- 104 395
2012	213 500	- 17 405
2013	238 333	164 172
2014	185 384	57 662
2015	703 000	619 0

94. Në analizë të sa më sipër, duke iu referuar vetëdeklarimeve të shtetasit M.Rr pranë organeve tatimore, nuk mund të arrihet të identifikohet vlera e blerjes së këtyre pajisjeve në vitin 2013.

95. Mbi ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi për shkak të funksionit të tij, Komisioni iu drejtua Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Durrës⁴⁶ nëse nga subjekti i rivlerësimit shtetasi M.Rr është hetuar në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës/veprave penale, është thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dëshmitar, i dëmtuar akuzues, viktimë në procedime apo kallëzime të hetuara nga subjekti i rivlerësimit dhe informohet⁴⁷ se nga verifikimi i bërë në sistemin kompjuterik, në të cilin administrohen hedhja e të dhënave për personat e dëmtuar dhe të kallëzuar, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të këtë hetuar çështje me personat e mësipërm. Prokuroria në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës informon se pas verifikimeve elektronike në Zyrën e Regjistrimit nuk rezulton se shtetasit për të cilët është kërkuar informacion, subjekti të këtë hetuar materiale hetimore për periudhën shtator 2008 – 6.6.2015, kur ka ushtruar funksionin si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Komisioni, gjithashtu, i drejtoi pyetje nëse ka hetuar gjatë ushtrimit të detyrës si oficer i policisë gjyqësore apo prokuror kallëzime penale ndaj apo të vetë z. M.Rr dhe përgjigjet se: *“Sqaroj se gjatë ushtrimit të detyrës time si oficer i policisë gjyqësore apo si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk kam hetuar asnjëherë kallëzime penale ndaj këtij shtetasi apo kallëzime të kryera nga ana e këtij shtetasi”*.

Qëndrimi i subjektit gjatë seancës dëgjimore

96. Subjektit të rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu drejtuan pyetje nga relatorja e çështjes, znj. Alma Faskaj, për t’u qartësuar pak më shumë lidhur me situatën e kontratës së huapërdorjes së pajisjeve dentare nga shtetasi M.Rr për të dhëna më të detajuara, si ka qenë, si ka lindur marrëdhënia e subjektit dhe bashkëshortes së tij me këtë shtetas dhe si ka evoluar marrja e pajisjeve dentare dhe deri sot si shkon kjo marrëdhënie, aftësinë paguese, aftësinë blerëse të shtetasit të këtyre pajisjeve dentare, pikërisht, në atë vit që i ka blerë.

Në kthim përgjigje, subjekti dha shpjegimet si vijojnë: *“Unë marrëdhënien me shtetasin M.Rr e kam nisur në vitin 2015, vit që përkon me hapjen e aktivitetit nga ana e bashkëshortes, duke qenë se me shtetasin M.Rr kisha një marrëdhënie po themi familjare duke qenë se ai është bashkëshorti i vajzës së hallës time. Ai ushtron aktivitet që prej vitit 2011 klinikë dentare, është me profesionin stomatolog. Gjatë bisedave më është vetofruar, në mënyrë që të mos shpenzoja lidhur me blerjen e pajisjeve, duke qenë se blerja e tyre po themi të reja ka një vlerë relativisht të lartë, se i kishte gjendje ato që të m’i jepte ato, ose po themi t’i përdorte bashkëshortja në huapërdorje duke qenë se sapo ishte hapur dhe klinika e tij. Kjo ka qenë marrëdhënia me këtë shtetas, është një marrëdhënie që bazohet po themi më shumë në mirëbesim ose në marrëdhënie familjare unë e njihja edhe më përpara këtë person dhe në këto kushte është nënshkruar edhe*

⁴⁶Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2021.

⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2021, e Prokurorisë së Rrethit Vlorë.

kontrata e huapërdorjes, bashkëshortja ka vijuar t'i përdorë këto pajisje me idenë për t'i zëvendësuar duke qenë se po themi vlera e tyre dhe viti i tyre i prodhimit tashme është, janë relativisht të vjetra pavarësisht se funksionin e kryejnë dhe janë në gjendje të mirë pune po themi, kështu që në këto kushte, duke parë dhe idenë që bashkëshortja mendon që t'i zëvendësojë dhe të blejë një palë të tjera, ka menduar që i ka përdorur, po themi, përgjatë këtyre viteve. Kjo ka qenë marrëdhënia. Por siç është konstatuar, unë kam deklaruar realisht atë çfarë ka ndodhur sepse siç është konstatuar edhe nga ana e Komisionit kanë qenë të gjitha mundësitë. Bashkëshortes mund t'ia blinin dhe prindërit ato pajisje duke qenë se është konstatuar aftësia pague e tyre, mund t'i blija dhe unë duke qenë se disponoja gjendje cash, por kam deklaruar para Komisionit realisht atë që ka ndodhur. Kjo është marrëdhënia me këtë shtetas, mendojmë që t'i zëvendësojmë në një të ardhme”.

Vlerësimi i Komisionit

97. Në vijim të shpjegimeve sa më sipër dhe në referencë të vendimit të Kolegjit⁴⁸ në vlerësim logjik e të arsyeshëm tërësor të të gjitha rrethanave të hetuara nga Komisioni mbi këtë marrëdhënie kontraktore, trupi gjykues vlerësoi se nisur nga fakti se prindërit e personit të lidhur të subjektit, bashkëshortes, kanë pasur aftësi financiare për të blerë pajisjet dentare objekt kontrate, provuar kjo edhe me vlerat e depozitimeve të kryera gjatë vitit 2015 nga shtetasja L.M, nëna e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e saj nga e cila indirekt konkludohet se mundësohet blerja e tyre edhe nëse do të konsideronim blerjen e pajisjeve nga shtetasja O.M. Sipas shpjegimeve të subjektit përgjatë hetimit, pajisjet janë ende në përdorim nga bashkëshortja e tij, e cila duket se nuk ka për qëllim blerjen e tyre, por zëvendësimin me pajisje të reja për shkak të amortizimit të tyre. Në analizë të dokumentacionit të depozituar në organet tatimore, në të cilat nga bashkëshortja e subjektit nuk deklarohen aktive të trupëzuara, është e vështirë të identifikohet vlera e këtyre pajisjeve. Referuar shpjegimeve të subjektit se ai ndodhet në pamundësi objektive provueshmërie të vlerës së sendeve objekt kontrate huapërdorje, vlerës së vogël të tyre, amortizimit⁴⁹ të tyre ku pajisjet në kuptimin fiskal dalin nga përdorimi zhvlerësohen pas 4-5 vjetësh nga data e deklarimit, si dhe nisur nga viti i prodhimit dhe gjendja e tyre, të përdorura sipas përshtimit në kontratën e huapërdorjes dhe fotove të përcjella nga subjekti gjatë hetimit, bazuar në të dhënat financiare të rezultuara nga hetimi për shtetasin M.Rr, provohet realizimi i të ardhurave nga aktiviteti “stomatolog” edhe në vitin 2013, vit në të cilin deklarohet nga subjekti se janë blerë prej tij pajisjet dentare objekt të kontratës së huapërdorjes datë 2.9.2015, bazuar në lidhjen familjare të subjektit dhe huadhënësit M.Rr.

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit në kuptim të procesit të rivlerësimit është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Nuk ka *indicie* për deklarim të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri dhe subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë dashur dhe nuk kanë pasur për qëllim ta fshehin pasurinë dhe marrëdhënien kontraktore objekt verifikimi.

Analiza financiare e vitit 2015 - 2016

Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga përlllogaritja e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo

⁴⁸http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendimi-i-SR-Alfred-Gjoni-i-anonimizuar_compressed.pdf

⁴⁹Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar pika 5 nenit 22 dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si vijon: (a) kompjuterë, sisteme informacioni, produkte *software* dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25%; (b) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 %. Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitet në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10 % e kostos historike të këtij aktivi, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore (ndryshuar me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24.12.2014.

kursimet e deklaruara dhe/ose të kursyera, me të ardhurat nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2015, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i subjektit në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar, ka rezultuar me një bilanc të përgjithshëm në vlerë negative prej 153,561 lekësh, për të cilën subjektit iu kalua barra e provës sipas pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor, të cilat janë përcjellë pas kalimit të barrës së provës, si dhe analizoi qëndrimin e tij në seancën dëgjimore për rezultatin e analizës financiare. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në arsyetimet dhe qëndrimet e mbajtura nga trupi gjykues, u arrit në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit mbetet i pandryshuar në vlerën negative 153,561 lekë.

Analiza financiare për periudhën qershor 2015 - 2016

<i>Përshkrimi</i>	1.6.2015 - 31.12.2015	2016
PASURI	16 030	1 156 958
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe <i>cash</i>	16 030	1 156 958
Gjendje kursimesh <i>cash</i>	770 000	870 000
<i>Total likuiditete</i>	669 580	1 826 538
DETYRIME	-71 137	-63 790
Kredi konsumatore në “RFZ”	-46 790	-89 708
Kartë krediti bankare në “RFZ” në vlerën 129,000 lekë	-51 484	
Kredi konsumatore 42,900 lekë në “RFZ” sh. a. nëna e subjektit	27 137	-27 137
Kredi konsumatore 69,730 lekë në “RFZ” sh. a. nëna e subjektit		53 055
PASURI NETO	87 167	1 220 748
TË ARDHURA dokumentuar	867 842	2 443 975
Të ardhura nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën korrik 2015 - 31.12.2016	429 890	1 392 544
Të ardhurat e bashkëshortes nga universiteti “***”		21 949
Të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti tregtar në kabinetin dentar “***” sh.p.k.		117 626
Të ardhurat e nënës së subjektit	312 834	661 620
Të ardhurat e babait të subjektit	125 118	250 236
SHPENZIME	447 498	1 376 788
Shpenzime qiraje për ambientin e ushtrimit të aktivitetit dentar të bashkëshortes, kontrata e lidhur prej datës 28.6.2015		120 000
Shpenzime interesi për kredinë në “RFZ”	25 339	27 209
Shpenzime interesi për kredinë në “RFZ”, e marrë nga nëna e subjektit	11 615	3 732
Shpenzime fjetjeje të deklaruara sipas grafikut të gatishmërisë	26 000	6 000
Shpenzime jetese	336 414	1 136 278
Shpenzime udhëtimi	48 130	83 569
Analiza dokumentuar	333 177	-153 561

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

98. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklaramë të sakta në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaramet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit.

B. KONTROLI I FIGURËS

99. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2021, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti në konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Arian Xhaferraj.

100. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni kreu hetimin administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit. Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Përgjithshme nëse shtetasit me të cilët ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit janë proceduar ose kanë kryer vepra penale dhe në analizë të të gjitha përgjigjeve të kthyer nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë nuk rezultoi se shtetasit me të cilët ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit të jenë proceduar penalisht pranë këtyre prokurorive. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Përgjithshme nëse subjekti i rivlerësimit ka të regjistruara procedim penal, mosfillim, ose pushim në ngarkim të tij dhe me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2021, janë përcjellë në Komision përgjigjet e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të rretheve gjyqësore. Referuar përgjigjes së Prokurorisë së Përgjithshme përgjigjja rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁵⁰, nga verifikimet e kryera për subjektin e rivlerësimit ka të regjistruara materiale procedurale dhe bashkëlidh me përgjigje edhe aktet penale të këtyre procedimeve si në vijim.

1. Kallëzim penal nr. * , datë 22.2.2018, mosfilluar me vendim datë 27.2.2018**

101. Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. *** , datë 27.2.2018, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 22.2.2018, mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal me nr. *** në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Nga shqyrtimi i materialeve kallëzuese rezultoi se në datën 19.2.2018 shtetasi Rr. D ka depozituar kallëzimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në kallëzimin e tij, shtetasi Rr.D pretendon se në kallëzimin e bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ndaj shtetasës L.A me detyrë ish-përgjegjëse e arkivit të Njësisë Administrative të ish-Komunës *** , si dhe shtetasin L.R me detyrë drejtues i Njësisë Administrative *** për veprën penale “shpërdorim detyre”, veprimet hetimore të të cilit janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Objekt i kallëzimit janë veprimet e shtetasve sa më sipër, të cilët në ushtrim të detyrës i kanë kthyer përgjigje z. Rr.D⁵¹.

102. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të hetimeve me vendim të datës 26.7.2016, ka vendosur “*mosfillimin e procedimit penal me nr.*** , të vitit 2017*”.Vendimi i mosfillimit i është komunikuar shtetasit Rr.D me shkresën nr.*** prot., datë 14.9.2017. Ndaj vendimit të mosfillimit ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë shtetasi Rr.D, e cila me vendimin nr. *** , datë 12.3.2018, ka vendosur “*mospranimin e ankimit penal të paraqitur nga ana e ankuesit Rr.D në lidhje me kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. *** , të vitit 2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë*”.

⁵⁰Shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2021, e Prokurorisë së Rrethit Fier.

⁵¹Kthim përgjigje nr. *** me përmbajtje: “*Në përgjigje të shkresës suaj me të cilën kërkohet informacion mbi pronësinë e sipërfaqes së tokës së z. Rr.D, ju bëjmë me dije se në dokumentacionin e disponuar në arkivin e kësaj Njësie Administrative nuk disponohet asnjë dokumentacion apo vendim për njohjen e pronësisë së z. Rr.D*”.

103. Mbi veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr.*** të vititi 2017, shtetasi Rr.D, në datën 22.2.2008, ka depozituar kallëzim në ngarkim të subjektit duke pretenduar se ka konsumuar elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”. Sipas kallëzuesit, argumentet në vendimin e organit të akuzës janë tepër sipërfaqësore dhe bien ndesh me vetë përmbajtjen dhe kuptimin e katër elementëve të veprës penale “shpërdorim detyre” duke filluar nga objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive. Në përfundim të kallëzimit, shtetasi Rr.D ka kërkuar rifillimin e hetimeve për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre” nga i akuzuari subjekti i rivlerësimit.

104. Prokuroria Fier, bazuar në materialin kallëzues në përfundim të hetimeve me vendimin për mosfillimin e procedimit penal të datës 27.2.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me nr. ***, datë 27.2.2018.

105. Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë Fier, shtetasi Rr.D ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. ***, datë 27.3.2018, ka vendosur “rrezimin e kërkesës ankimore me ankues Rr.D”.

Vlerësimi i Komisionit

106. Nga analiza e akteve të dosjes penale dhe sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vlerësohet se në dinamikën e veprimeve hetimore të procedimit penal nr. ***, të kryera nga subjekti në cilësinë e prokurorit të çështjes nuk janë vërejtur mangësi të karakterit procedural. Pretendimet e shtetasit Rr.D kanë të bëjnë më menyrën e zgjidhjes së çështjes, të cilat kualifikohen në kuadër të kërkesave penale për të cilat duhet t’i drejtohej gjykatës me ankim ndaj vendimit të mosfillimit në Gjykatën nën juridiksionin e së cilës z. Arian Xhaferraj ushtron funksionin, të drejtë ligjore të cilën ky shtetas e ka ezauruar. Bazuar në përcaktimet e pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, i cili përcakton se “*vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet*”, Komisioni gjendet para pengesës ligjore për të vlerësuar kualifikimin e veprës penale, arsyetimin dhe analizimin e elementëve të saj, të cilat janë tagër e prokurorit, bazuar në provat dhe bindjen e tij të brendshme dhe duke qenë të lidhura me themelin e çështjes dalin jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit, për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni iu referua edhe jurisprudencës së Kolegjit⁵², i cili ndër të tjera, shprehet: “*Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin dhe çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht, vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit*”. Në konkluzion të analizës sa më sipër, trupi gjyqësor nuk evidentoi shkaqe që mund të shkaktonin cenimin e besimit të publikut nga subjekti për shkak të trajtimit të kësaj çështjeje, referuar edhe faktit se vendimmarrja e prokurorit pas shqyrtimit gjyqësor është vlerësuar e drejtë nga Gjykata e Apelit Vlorë, si i vetmi autoritet që mund të kontrollojë çështjet e vendimmarrjes si në rastin konkret.

2. Kallëzim penal nr. *, datë 25.4.2018, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal**

⁵²http://kpa.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim_Ndini_Tavani_anonimizuar.pdf

107. Rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 7.2.2017 është depozituar kallëzimi penal i shtetaseve M dhe I.B dhe është regjistruar procedimi penal nr. ***. Kallëzuesit pretendojnë se në datën 23.3.2016 kanë shkuar në pronën e tyre në vendin e quajtur *** në fshatin ***, Vlorë dhe kanë parë rreth 10 persona që po punonin për shpyllëzimin e ullinjve dhe të shkurreve që gjendeshin brenda pronës së tyre. Po ashtu, ata kanë konstatuar edhe dy ekskavatorë dhe një mjet transporti në të cilin punëtorët që gjendeshin aty po ngarkonin ullinjtë dhe mbeturinat e prera dhe të shkulura nga toka. Kallëzuesit kanë parë në vendin e ngjarjes shtetasit M.P, A.D dhe G.Gj. Në kushtet e mësipërme, duke i konsideruar veprimet e padrejta, kallëzuesit kanë lajmëruar policinë. Policia ka shoqëruar vetëm shtetasin M.B duke i shpjeguar se punimet po kryhen në mënyrë të ligjshme. Kur janë kthyer sërish, kallëzuesit pretendojnë se kanë konstatuar dëme të mëdha materiale⁵³. Në kushtet e mësipërme kallëzuesit kanë depozituar kallëzim penal për veprën penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal nga shtetasit M.P, A.D dhe G.GJ, si dhe ndaj policit të zonës z. E.A për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248.

108. Veprimet hetimore të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, janë kryer nga subjekti i rivlerësimit.

109. Gjatë hetimit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka kryer verifikimet pranë Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga të cilat rezultoi se është regjistruar procedimi penal me nr. ***, i vitit 2016 për veprën penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve I dhe M.B. Pas verifikimeve të kryera është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendim të cilin subjekti e ka administruar në dosjen hetimore.

110. Në përfundim të veprimeve verifikuese subjekti, ka vendosur “*Mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017*”. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar në vendimmarrjen e tij se referuar materialeve hetimore të administruara nga procedimi penal me nr. ***, i vitit 2016 lidhur me ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal është shqyrtuar dhe ka qenë pjesë e veprimtarisë procedurale nga organi i akuzës dhe më pas është marrë dhe vendimi përkatës. Në përfundim të hetimit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se e njëjta vepër penale i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar apo liruar dhe bazuar në parimin “*ne bis in idem*” ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

111. Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, ka ushtruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë shtetasit M dhe I. B. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 9.4.2019, ka vendosur: “*Mospranimin e ankuesve M dhe I.B kundër vendimit nr. ***, të vitit 2017*”. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë shtetasit M dhe I.B, e cila me vendimin nr. ***, datë 5.6.2019, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 9.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke pranuar ankimin ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, shfuqizimin e vendimit nr. *** dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për vijimin e hetimeve*”.

Gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit ka arsyetuar se: “*Ndjekja penale është kompetencë ekskluzive e prokurorit, i cili bën vlerësimin nëse ndjekja penale është apo jo e domosdoshme. Gjykata e Apelit vlerëson se veprimet verifikuese të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për materialin kallëzues nuk janë kryer të plota, jo sipas ligjit procedural penal dhe janë të*

⁵³Ishin shkulur 20 rrënjë ullinj shumëvjeçarë dhe vlera e dëmit përlogaritej rreth 2,000,000 lekë.

nevojshme hetime të mëtejshme”. Në vendimin e gjykatës relatohen edhe veprimet plotësuese, të cilat janë konstatuar se nuk janë kryer nga subjekti në cilësinë e prokurorit të çështjes.

112. Bazuar në urdhërimet e vendimit të Gjykatës së Apelit është regjistruar procedimi penal me nr. ***, i vitit 2019.

113. Në aktet e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, të përcjella nga Prokuroria e Rrethit Fier, gjendet “deklaratë për heqje dorë nga hetimi i procedimit penal me nr. ***, i vitit 2019, i subjektit të rivlerësimit e datës 4.12.2019”. Me vendimin e datës 21.1.2020, Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë ka vendosur zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit dhe ndjekjen e hetimeve për këtë procedim nga një tjetër prokuror.

114. Lidhur me veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit, në kallëzimin penal nr. *** kallëzuesit kanë depozituar kallëzim në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila e ka përcjellë për kompetencë ndjekjen e tij në Prokurorinë e Rrethit Fier.

115. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e kallëzimit të shtetasve I dhe M.B drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ka regjistruar kallëzimin penal me nr. ***, të vitit 2017. Prokuroria e Rrethit Fier ka analizuar se fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e shtetasve I dhe M. B, pasi fakti nuk parashikohet si veprë penale.

116. Në vendimin e mosfillimit të kallëzimit penal me nr. ***, datë 30.4.2019, Prokuroria e Rrethit Fier është shprehur edhe në lidhje me pretendimet për vendimin e mosfillimit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, marrë nga subjekti i rivlerësimit. Prokuroria e Rrethit Fier ka argumentuar se në zbatim të nenit 291 e vijues të Kodit Penal parashikohet e drejta e kallëzuesit të kundërshtojë vendimin e mosfillimit në gjykatë dhe është pikërisht gjykata ajo që verifikon bazueshmërinë e vendimit. Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal me nr. ***, datë 25.4.2018, kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kallëzuesit I dhe M.B ku gjyqtari i hetimeve paraprake me vendimin nr. ***, të datës 24.10.2019, ka vendosur: “*Rrëzimin e ankimit të ankuesve I.B dhe M.B ndaj vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier të datës 30.4.2018 “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 25.4.2017”*”. Ndaj vendimit nr. ***, të datës 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë shtetasit I dhe M.B, e cila me vendimin nr. ***, datë 2.10.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, të datës 24.10.2019.

117. Në konkluzion të sa më sipër në analizë të veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe pretendimeve të ankuesve I dhe M.B, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota lidhur me identifikimin e elementëve të veprës penale “shkatërrim i pronës”, duke bërë edhe kualifikim të gabuar të parimit “*ne bis in idem*”. Parimi “*ne bis in idem*” mundëson që askush nuk mund të ndiqet dhe as të gjykohet për veprën penale për të cilën është liruar ose akuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Në nenin 34 të Kushtetutës parashikohet se: “*Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale ...*”. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon parimin “*ne bis in idem*”, personi nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën shkelje të ligjore, e cila nuk gjen zbatim në rastin e procedimit penal me nr. ***, të vitit 2017, si një vendim jopërfundimtar dhe i atakueshëm gjyqësisht.

118. Me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me konstatimet sa më sipër të Komisionit.

118.1 Pas njohjes me rezultatet e hetimit subjekti prapësoi si vijon: “*Materiali kallëzues i mësipërm është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve M dhe I.B, banuese në*

fshatin ***, Himarë. Sipas pretendimeve të parashtruara në materialin kallëzues, kallëzuesit kanë pretenduar se në datën 23.3.2016, pasi kanë shkuar në një pronë të tyre të ndodhur në vendin e quajtur '***', fshati ***, kanë konstatuar rreth dhjetë persona, të cilët sipas tyre po punonin për shpyllëzimin e ullinjve dhe të shkurreve që gjendeshin brenda pronës së tyre. Po kështu, ata kanë konstatuar edhe dy ekskavatorë dhe një makinë transporti në të cilën punëtorët që gjendeshin aty po ngarkonin ullinjët dhe pemët e prera nga toka. Më tej, kallëzuesit pretendojnë se janë shoqëruar më pas nga policia dhe kur janë rikthyer sërish në vendin e ngjarjes kanë konstatuar se ishte prishur rrethimi i mëparshëm me tel i pronës; ishin shkukur njëzetë rrënjë ullinj shumëvjeçar; ishin dëmtuar njëzetë e dy copë dyer dhe dritare material duralumini. Sipas tyre, vlera e dëmit të shkaktuar në rastin konkret kapte shifrën prej 2.000.000 lekë të reja. Referuar pretendimeve të mësipërme, kallëzuesit kanë kërkuar fillimin e ndjekjes penale për veprën penale 'shkatërrim prone', parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, si dhe për veprën penale 'shpërdorim detyre', parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj punonjësit të policisë të Stacionit të Policisë Himarë, shtetasit E.A. Aktet e administruara në funksion të verifikimit të këtij materiali kallëzues. Në lidhje me verifikimin e pretendimeve të këtij materiali kallëzues, me urdhrin 'Për delegimin dhe kryerjen e veprimeve verifikuese' të datës 13.2.2017, është deleguar policia gjyqësore për kryerjen e disa veprimeve verifikuese dhe konkretisht janë administruar aktet si :(a) është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, kallëzuesi, shtetasi M.B; janë pyetur në cilësinë e personave që kanë pasur dijeni në lidhje me ngjarjen shtetasit G.Gj; M.P; Është pyetur në lidhje me faktet objekt kallëzimi, punonjësi i policisë që mbulonte zonën, shtetasi E.A; është administruar kopje e vendimit të mosfillimit të materialit kallëzues me nr. ***, të vitit 2016, si dhe shkresa përcjellëse për njoftimin e palëve. Në përfundim të veprimeve verifikuese, nga ana ime si prokuror i çështjes është vendosur mosfillimi si procedim penal i materialit kallëzues me nr. ***, të vitit 2017. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit të ankuesve M.B dhe I.B. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga ana e shtetasve M dhe I.B dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin me nr. ***, datë 9.4.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit me nr. ***, datë 9.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë duke pranuar ankimin e paraqitur nga ana e shtetasve M dhe I.B, si dhe duke shfuqizuar vendimin për mosfillimin si procedim penal të materialit kallëzues me nr. ***, të vitit 2017 dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për vijimin e hetimeve.

Në lidhje me vendimmarrjen time si prokuror që ka trajtuar materialin e mësipërm, sqaroj se jam bazuar në aktet e administruara gjatë verifikimit të këtij materiali kallëzues. Për sa shpjegova më sipër, jam i qëndrimit se në rastin konkret argumentet e vëna në themel të vendimit të mosfillimit të materialit kallëzues me nr. ***, të vitit 2017, kanë qenë të drejta dhe në përputhje me aktet e administruara gjatë verifikimit të këtij materiali kallëzues”.

Qëndrimi i subjektit gjatë seancës dëgjimore

119. Lidhur me materialin kallëzues të shtetasve I. B. dhe M. B. subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore shpjegoi: “Konkretisht këta, për të cilin kam thënë që ndodhemi para parimit ‘ne bis in idem’. Këta shtetas në marrëdhënie të posaçme me njeri-tjetrin, për shkak se ishin bashkëshortë, kanë depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar fillimin e ndjekjes penale për veprën penale ‘shkatërrim i pronës’, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj inspektorit të policisë së zonës, ku pretendohet se kishte ndodhur ngjarja. Lidhur me këtë fakt, menjëherë sapo jam njohur me materialin kallëzues nëpërmjet urdhrin për delegimin e kryerjes së veprimeve verifikuese, kam ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore që të kryejë disa veprime verifikuese në kuadër të këtij materiali kallëzues për shkak se nuk ishte regjistruar si procedim penal. Konkretisht, është thirrur dhe

është pyetur kallëzuesi lidhur me pretendimet që ai parashtronte në kallëzimin penal. Janë thirrur disa prej personave të kallëzuar në materialin kallëzues, është kërkuar nga kallëzuesi të depozitonte material lidhur me dokumentacionin e pronësisë dhe, po kështu, është pyetur edhe inspektori i policisë së zonës, i cili kallëzohej në atë material kallëzues. Nga verifikimet, ndër të tjera, nga verifikimet në zyrën e regjistratit ka rezultuar që më parë ishte trajtuar një material kallëzues, ku palë të përfshira ishin dhe kallëzuesit pavarësisht se nuk ishin në cilësinë e kallëzuesve. Pasi kanë vlerësuar aktet e administruara, si dhe veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, por edhe aktet e marra me procesverbal për këqyrje dhe marrje dokumenteve nga materiali kallëzues nr. ***, kam konstatuar se në rastin konkret bëhej fjalë për një rast, për një sjellje, për një veprim, për një fakt i cili ishte i njëjtë me atë të ndodhur dhe që ishte trajtuar në kuadër të materialit kallëzues me nr. ***. Konkretisht, edhe në materialin me nr. ***, të cilit i jam referuar, bëhej fjalë për të njëjtat palë në konflikt, bëhej fjalë për të njëjtën ditë kur kishte ndodhur konflikti. Objekti mbi të cilin palët kundërdrejtonin pretendimet e tyre ishte i njëjtë, pra ishte e njëjta pronë e ndodhur në të njëjtin vend, me të njëjtat palë, i njëjti konflikt dhe në këtë kuadër në rast se do të kishte një pretendim për shkatërrim prone nga kallëzuesit, ky pretendim do të ishte parashtruar që në momentin që ishte iniciuar materiali kallëzues nr. ***, ndërkohë që fakt i cili nuk kishte ndodhur në rastin konkret. Madje do të thosha që pretendohet nga kallëzuesit M. B. dhe I. B. shkatërrim prone, ndërkohë që qoftë në momentin që janë thirrur në prokurori dhe janë pyetur, qoftë në materialin kallëzues që ata kishin depozituar nuk dispononin asnjë dokument pronësie si parakusht bazë mendoj për të filluar apo për të iniciuar një procedim penal për veprën penale 'shkatërrim i pronës'. Kështu që në këto kushte vlen të theksoj se vendimi i mosfillimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë pavarësisht se është prishur nga vendimi, nga Gjykata e Apelit. Sigurisht që vendimi i Apelit është një vendim detyrueshmëria e të cilit nuk vihet në diskutim, por unë do të thosha që do të doja vetëm të ndaloja në një moment te pjesa arsyetuese e këtij vendimi duke qenë se e ka cenuar një vendimmarrje time për të cilën unë jam duke dhënë shpjegime sot, Gjykata e Apelit në rastin më të mirë nuk e ka lex.. nuk e ka parë fare dosjen e mosfillimit. Pse e them këtë? Sepse në pjesën arsyetuese gjykata arsyeton dhe thotë: 'Nga organi procedues nuk është thirrur kallëzuesi dhe nuk është pyetur lidhur me faktet objekt kallëzimi', ndërkohë që në materialin kallëzues trajtuar nga ana ime është thirrur kallëzuesi dhe ka dhënë shpjegime të hollësishme. Në pjesën arsyetuese, Gjykata e Apelit thotë që: 'Nuk janë pyetur personat e kallëzuar', ndërkohë që në materialin kallëzues ishin pyetur tre prej personave të kallëzuar dhe janë marrë shpjegime të hollësishme. Gjykata e Apelit, në pjesën arsyetuese, thotë që 'nuk është administruar dokumentacion pronësie', ndërkohë që kallëzuesit nuk dispononin dokumentacion pronësie dhe veprimi tjetër që gjykata thotë: 'të kryhet ekspertim lidhur me vlerën e dëmit', ndërkohë që ngjarja, dua ta theksoj këtë, që ngjarja kishte ndodhur rreth 11 muaj para sesa kallëzuesit M. B. dhe I. B. të depozitonin kallëzim penal për të cilin unë jam shprehur me vendim mosfillimi. Pra, praktikisht edhe pavarësisht se ai procedim është regjistruar, është e pamundur që të kryhej një ekspertim për shkatërrim prone për një ngjarje e cila rezulton të ketë ndodhur rreth 11 muaj duke qenë se në dosje nuk kishte as procesverbal të këqyrjes së vendit të ngjarjes për të përcaktuar sendet konkrete që ishin prishur, sasia e tyre, lloji i tyre për të përcaktuar kufizimet e vendit të ngjarjes, element këto besoj të domosdoshme për të arritur në një konkluzion objektiv lidhur me pretendimet. Kështu që, në rastin konkret, duke pasur parasysh edhe praktikën dhe vendimmarrjen, jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku gjykata tashmë ka bërë edhe një definicion se çfarë quhet vepër e njëjtë. Një tërësi faktesh dhe rrethanash të njëjta dhe të lidhura me njëra-tjetrën pavarësisht nga cilësimi juridik. Kam gjykuar që në rastin konkret nga ana jonë si organ procedues nuk mund të regjistrohej një procedim i ri penal duke qenë se këto pretendime në rast se do të ekzistonin realisht, do të ishin parashtruar në materialin nr. ***, për më tepër edhe prokurori që kishte trajtuar materialin tjetër në rast se do të evidentonte një vepër tjetër

të kallëzuar ose jo në materialin kallëzues që ai kishte përpara, sigurisht që kishte detyrimin ta regjistronte, gjë që në rastin konkret nuk kishte rezultuar. Prandaj, në gjykimin tim, vendimmarrja ka qenë e drejtë, e bazuar në aktet dhe provat e paraqitura nga ana ime”.

120. Gjatë seancës dëgjimore, subjektit të rivlerësimit iu drejtuan pyetje nga anëtarë të trupit gjykues. Nisur nga fakti se kjo çështje është bërë publike iu kërkua të japë shpjegime të hollësishme për mosveprimet e konstatuara nga Gjykata e Apelit, e cila ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore lidhur me kallëzimin për shkatërrim prone përfshi edhe faktin se subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka një fillim prove me shkresë dhe “populli i thjeshtë” është i pafuqishëm për t’iu kthyer prona përveçse të bëjë kallëzim.

Subjekti i rivlerësimit, në vijim të pyetjes sa më lart, është përgjigjur: *“Veprimet që ishin kryer në funksion të verifikimit të këtij kallëzimi penal, pra nuk ka qenë vetëm materiali tjetër kallëzues që më ka bindur për ta marrë atë vendim, janë kryer veprimet përkatëse dhe pikërisht prandaj e citova që edhe Gjykata e Apelit besoj që nuk i ka shqyrtuar fare aktet që ndodheshin në dosje, pra kallëzuesi ishte pyetur, personat e kallëzuar ishin pyetur por nuk u paraqit, qoftë edhe AMTP, nuk u paraqit asnjë dokumentacion pronësie qoftë nga kallëzuesit nuk kishte asnjë dokumentacion. Ata nëse do të duhet t’i përkufizoja do të thosha që ishin thjeshtë pretendues. Më parë ka pasur dhe procedime të tjera penale për të njëjtë, me të njëjtët kallëzues pa i paragjykuar, nuk ka ndikuar në vendimmarrjen time fare madje i kam kushtuar vëmendjen e duhur këtij materiali kallëzues, pretendime që kishin të bënin me falsitetin e dokumentacionit të palës tjetër, pretendime, të cilat janë rrëzuar në kohën për të cilën po flasim këta kallëzues kanë paraqitur një duzinë kallëzimesh, thjesht dhe vetëm me pretendimin që ishin dhe ata pronarë, por ndërkohë prona ishte e regjistruar në zyrat e ASHK-së. Gjykata tha nuk është hetuar, por realisht ato gjëra që thotë gjykata nuk janë bërë, ato ishin bërë, ishin kryer, janë veprime që ishin kryer”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

121. Në referim të shpjegimeve sa më sipër të dhëna nga subjekti, lidhur me zbatimin e parimit “*ne bis in idem*” në mosfillimin e procedimit penal nr. ***, ai nuk është gjetur i drejtë edhe nga gjykata. Në këndvështrim edhe të jurisprudencës së Kolegjit, vlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit në funksion të ushtrimit të tij kushtetues si prokuror, do t’i nënshtrohet veprimeve hetimore deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. **. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime hetimore, por nuk ka përmbushur detyrën e tij për të zgjeruar rrethin e hetimeve lidhur me mbledhjen e provave dhe fakteve për të provuar mbi vërtetësinë e pretendimeve në kallëzim që mund të tregonin të tjera rrethana, të cilat do të mund të përbënin element të veprës penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.

Sa më sipër referuar edhe vendimit të Kolegjit⁵⁴, duke marrë në konsideratë faktin se ky është një rast i vetëm në vlerësimin e kriterit profesional dhe në dosje rezultojnë të jenë kryer veprime të konsiderueshme procedurale që kanë orientuar subjektin në vendimmarrje, kjo shkelje nuk mund të vlerësohet deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për mangësi profesionale, në kuptim të pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 apo cenim të besimit të publikut, në aplikim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

3. Kallëzimi penal nr. *, datë 5.2.2020, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “shpërdorim detyre”, regjistruar për disa prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Vlorë. Ndër prokurorët e kallëzuar është subjekti i rivlerësimit. Dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal nga prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë në datën 7.2.2020**

⁵⁴http://kpa.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim_Ndini_Tavani_anonimizuar.pdf

dhe vendimin nr. *, datë 24.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është vendosur pranimi i kërkesës dhe pushimi i procedimit penal.**

122. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 5.2.2020, ka regjistruar procedimin penal me nr. *** për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, me kallëzues M dhe I.B. Ky procedim është regjistruar mbi bazën e vendimit të shpalljes së moskompetencës datë 30.12.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në datën 18.9.2017, Prokuroria e Rrethit Fier mbi bazën e kallëzimit të dërguar për kompetencë nga Drejtoria e Hetimit dhe Përfaqësimit në Gjykim në Prokurorinë e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në lidhje me veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në datën 18.9.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier mbi bazën e kallëzimit të dërguar për kompetencë nga Drejtoria e Hetimit dhe Përfaqësimit për Gjykim në Prokurorinë e Përgjithshme, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në lidhje me veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Me vendimin e datës 22.9.2017 është vendosur bashkimi i procedimeve të mësipërme në një të vetëm, konkretisht, të procedimit penal me nr. *** për veprën penale “shpërdorim detyre”.

Prokuroria e Rrethit Fier ka paraqitur në datën 29.12.2017, kërkesën për pushimin e procedimit penal drejtuar gjykatës me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 2.7.2018, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për vazhdimin e hetimeve”*.

Në datën 1.8.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka shpallur moskompetencën për procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, me objekt hetimi veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Materiali është regjistruar me numër procedimi ***, të vitit 2018, për të njëjtin objekt hetimi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në datën 27.12.2019 është zgjeruar objekti i hetimit duke urdhëruar regjistrimin e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Për shkak se hetimi për këtë veprë penale nuk ishte i plotë dhe ndarja nuk dëmtonte çështjen, është proceduar me hetimin e kësaj veprë penale më vete në kuadrin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2109.

Shtetasit I dhe M.B kanë kallëzuar faktin se në datën 6.7.2016 i janë drejtuar me kallëzim Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në të cilin kallëzoheshin:

- Policia e Stacionit Policor *** për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për fshehje të autorëve që kanë kryer veprën penale duke i shtyrë kallëzuesit në konflikt.
- Bashkia Himarë për dhënien e lejeve për kabinat e drurit brenda pronës së tyre, e cila ka qenë e bllokuar me sigurim padie deri në zgjidhjen e çështjes.

Veprime hetimore që nuk janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit

Gjithashtu, në datën 3.7.2017 shtetasit M dhe I.B kanë paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme një kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi kanë parashtruar se sipas dosjes së

vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe disa prokurorë të tjerë të Vlorës kanë kryer veprën penale “falsifikim dokumentesh” në bashkëpunim. Shtetasit I dhe M.B kanë bërë kallëzim penal për prokurorët e Prokurorisë së Rrethit Vlorë, pasi ata nuk kanë kryer detyrën e tyre lidhur me disa kallëzime që kanë paraqitur në prokurori.

Konkretisht, shtetasit I dhe M.B kallëzojnë veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. ***.

Procedimi nr. *** është trajtuar në relacion sa më sipër. Lidhur me procedimin penal nr. *** shtetasit I dhe M.B kanë ezuaruar edhe ankimin gjyqësor.

Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Rrethit Fier me vendimin e datës 7.2.2020 ka vendosur: *“Pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2020, i regjistruar për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”*.

Ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr.***, të vitit 2020, kanë ushtuar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier shtetasit M dhe I.B, e cila me vendim nr. ***, datë 24.9.2020, ka vendosur: pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. *** me datë regjistrimi 5.2.2020 për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ka ushtuar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë shtetasit I dhe M.B, e cila me vendimin nr. ***, datë 6.1.2021, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 24.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”.

➤ **Gjatë hetimit, Komisioni, nga burime të medias elektronike, ra në dijeni⁵⁵ të faktit se subjekti i rivlerësimit ishte duke ndjekur veprimet hetimore në ngarkim të shtetasit F.T, i hetuar në masën e sigurimit personal “arrest shtëpie”**

123. Fakti penal bën fjalë për ndalimin e anijes “****” në Vlorë, e cila dyshohej se transportonte lëndë toksike, ku pretendohet se edhe pse ka rezultuar nga ekspertimi se lënda nuk ishte toksike, shtetasi F.T ishte ende nën masën e sigurimit “arrest shtëpie”. Sa më sipër, Komisioni iu drejtua me shkresë Prokurorisë së Rrethit Vlorë, e cila bën me dije se procedimi penal nr. 321/2021, regjistruar për veprat penale “menaxhim i mbetjeve” dhe “transportim i mbetjeve”, “kontrabanda me mallra të ndaluar ose të kufizuar e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 201/a,201/b, 171 dhe 25 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve F.T, K.Xh, E.Ç, A.Ç, Z.K dhe A.B është në hetim dhe hetimet nuk kanë përfunduar ende.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

124. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2021, përcjell në Komision raportin për vlerësimin e aftësisë aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit dhe aktet bashkëlidhur tij. Ky raport është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. ***, datë 25.10.2021, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për Vlerësimin Etik e Profesional të Subjekteve në Proces Rivlerësimi” ka miratuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike

<https://tvklan.al/anija-e-ndaluar-per-mbetje-toksike-rezulton-e-paster-por-kapiteni-mbetet-ne-arrest-shtepie/>

për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Arian Xhaferraj, prokuror pranë Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në raportin e Komisionit të Vlerësimit pranë KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar nivele të mira në aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Arian Xhaferraj, ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit të ushtrimit të detyrës ka punuar në fushën e të drejtës penale dhe procedurale penale si prokuror.

125. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë konstatohet se:

- subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj, në periudhën shtator 2007 – shtator 2008 ka ushtruar detyrën si as/avokat pranë studios së av. ***;
- me urdhrin nr. ***, datë 4.9.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj është emëruar oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ka punuar në periudhën shtator 2008 – qershor 2015;
- me Dekretin nr. ***, datë 1.6.2015, të Presidentit, subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

126. Subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, është vlerësuar për punën e kryer prej tij, aftësitë e tij profesionale dhe etike për vitet 2015 dhe 2016, me “shumë mirë”.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

127. Gjatë periudhës së vlerësimit, prokurori Arian Xhaferraj ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, si vijojnë:

- i. kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2015”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- ii. vendim “Për pushimin e procedimit dhe hetimeve në procedimin penal nr. ***, të vitit 2015” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- iii. konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. ***, të vitit 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti konstatohet nga Komisioni se nga analiza e kryer për këto tri dokumente ligjore, si nga Grupi i Punës pranë KLP-së, ashtu edhe nga Komisioni, nuk u konstatuan problematika që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit.

Përshkrimi i pesë dosjeve penale dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short

128. Nga shorti i hedhur u përzgjedhën në mënyrë rastësore dy vendime për mosfillimin e procedimit penal, një vendim pushimi dhe 2 vendime për dërgimin e çështjes në gjyq.

Dosja nr. 1 – kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 7.8.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Dokumenti ligjor – vendim për mosfillimin e procedimit penal datë 18.9.2015, për kallëzimin penal nr. ***, datë 7.8.2015.

Dosja nr. 2 – kallëzim penal nr. ***, regjistruar në datën 7.2.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Dokumenti ligjor, vendim “Për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, datë 7.9.2019”, përpiluar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Dosja penale nr. 3 – procedimi penal nr.***, regjistruar në datën 25.4.2014 për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283, paragrafi 2, i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor – vendim për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, të vitit 2015, datë 22.2.2016.

Dosja nr. 4 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 4.3.2015, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Dokumenti ligjor – konkluzione përfundimtare të çështjes penale nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit E.H.

Dosja nr. 5 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 14.9.2015, në ngarkim të shtetasit E.Z, akuzuar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. Dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. 1857/2015”.

Pas administrimit të dokumentacionit, trupi gjykues konstatoi problematika në dy dosjet si vijon:

129. Dosja nr. 1 – kallëzimi penal nr. ***, regjistruar në datën 7.8.2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Dokumenti ligjor i analizuar “vendim për mosfillimin e procedimit penal datë 18.9.2015, për kallëzimin penal nr. ***, datë 7.8.2015”.

Viktima A.G i datëlindjes 21.11.199, punonte si ndihmëskamerier në hotel “*****” ***, Himarë, Vlorë. Në datën 1.8.2015, rreth orës 17:30, viktima ka shkuar në plazh. Shtetasit E.M dhe E.M kanë qenë te çadrat duke bërë plazh dhe rreth orës 18:00 kanë konstatuar në det një trup personi, i cili qëndronte gjysmë i zhytur në ujë, në pozicionin përmbys dhe nuk lëvizte. Kur dallga e ka kthyer këtë person në anën tjetër kanë nxjerrë trupin e viktimës nga deti, janë munduar t’i japin ndihmën e parë dhe disa pushues të tjerë e kanë transportuar me ambulancë drejt Spitalit Rajonal ***. Në datën 7.8.2015, Komisariati Vlorë ka referuar në Prokurorinë e Rrethit Vlorë materialin hetimor, i cili është regjistruar me numër kallëzimi ***. Me ndjekjen e çështjes është ngarkuar subjekti i rivlerësimit, i cili ka kryer veprimet hetimore duke administruar edhe aktekspertimin mjeko-ligjor nr. ***, datë 1.8.2015, tabelën fotografike datë 4.9.2015. Në përfundim të hetimeve me vendim të datës 18.9.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “Mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2015”. Dokumenti vendim mosfillimi është i strukturuar në tri pjesë, në pjesën hyrëse, në pjesën përshkuese dhe arsyetuese dhe dispozitivi. Akti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm. Në paraqitjen e rrethanave të faktit ka një lapsus në datëlindjen e viktimës, ku është cituar data 25.7.2004 në vend të datës 21.11.1997. Në vendim, subjekti ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit. Me shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2015, vendimi i është dërguar për njoftim shtetasit R.G. Rezulton se palët e interesuara nuk kanë ushtruar ankim në gjykatë ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2015.

130. Sa më sipër, Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se vendimi i mosfillimit, i marrë në datën 18.9.2015, referuar datës 7.8.2015, datë në të cilën materiali kallëzues ka bërë hyrje në prokurori dhe është marrë jashtë afatit 30-ditor, i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimeve të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”.

131. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi tejkalimin e afatit 30-ditor të marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit nr. ***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

132. Subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me rezultatet e hetimit, parashitroi: “Materiali referues është bërë hyrje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 7.8.2015 dhe është numërtuar me nr. *** kallëzimi, datë 7.8.2015. Deri në datën 31.8.2015 ky material

*nuk ka qenë i ndarë dhe i deleguar te prokurori që do ta shqyrtonte atë. Në datën 31.8.2015, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është bërë shënimi 'z. Xhaferraj 31.8.2015' dhe nënshkrimi i drejtuesit. Me anë të këtij shënimi jam caktuar prokurori që do të kryente verifikimin e këtij materiali kallëzues. Pra, rezulton se nga momenti kur më është caktuar për ndjekje dhe veprim material kallëzues me nr. ***, që është data 31.8.2019 dhe deri në momentin që kam marrë vendimin për mosfillimin e tij, kohëzgjatja e trajtimit të këtij materiali nga ana ime ka qenë 18 ditë. Pavarësisht, faktit që materiali kallëzues është regjistruar në datën 7.8.2015 dhe deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit, rezulton të jetë kaluar afati prej 30-ditësh ...”.*

133. Subjekti i rivlerësimit, në seancë dëgjimore, mbajti të njëjtin qëndrim dhe dha të njëjtat shpjegime me shpjegimet dhe qëndrimin e mbajtur gjatë hetimit. Subjekti, mbi shpjegimet sa më sipër, depozitoi në seancë dëgjimore dokumentacion provues⁵⁶.

Vlerësimi i Komisionit

134. Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen hetimore, deklarimeve të subjektit gjatë hetimit, shpjegimeve dhe dokumentacionit provues të dorëzuar në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se referuar shpjegimeve sa më sipër, bazuar në datën 31.8.2015 të caktimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për ndjekjen e hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, vendimi i pushimit i marrë në datën 17.9.2015 është marrë brenda afatit ligjor 30-ditor, të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimeve të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”. Trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike si më sipër, çmon se, bazuar në pikën 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të jetë objekt rivlerësimi.

Dosja penale nr. 3 procedimi penal nr. *, regjistruar në datën 25.4.2014 për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283, paragrafi 2, i Kodit Penal. Dokumenti ligjor i analizuar – vendim për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, të vitit 2015, datë 22.2.2016.**

135. Seksioni për narkotikët në Drejtorinë e Policisë Qarku Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.8.2015, ka dërguar në prokurori të dhënat mbi disa persona me precedentë penal që dyshoheshin se merreshin me veprimtari kriminale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, kryesisht të lëndës *Canabiss Sattiva*. Kjo veprimtari kriminale dyshohet se kryhet në bashkëpunim dhe shtrihet në territorin e qarkut të Vlorës dhe në fshatin ***, Komuna ***. Nga të dhënat është siguruar informacioni se shtetasit N.M, J.M, A.M, Q.M, S.B dhe E.M në bashkëpunim me njëri - tjetrin kanë kultivuar bimë narkotike të llojit *Canabiss Sattiva* në fshatin Kotë dhe në fshatra të tjera të rrethit Vlorë si ***, ***, ***. Dyshohet se këta shtetas kanë marrë shtëpi me qira në fshatin ***, në të cilën mendohet se bëhet fshehja e lëndës narkotike të kultivuar prej tyre. Nga të dhënat operative rezulton se shtetasit e mësipërm kanë trafikuar në vitin 2014, në drejtim të Italisë me gomone sasira të konsiderueshme të lëndëve narkotike të llojit *Canabiss Sattiva*, ku edhe janë kapur nga autoritetet italiane. Mbi bazën e informacionit sa më sipër është kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë vënia në përgjim telefonik të disa numrave në përdorim nga personat e dyshuar se kryenin veprimtarinë kriminale. Në funksion të hetimit është autorizuar policia gjyqësore me vendimet e datave

⁵⁶Shkresë nr.*** prot., të Komisarariatit të Policisë Vlorë, si dhe procesverbali “Për dorëzimin e akteksptimeve mjeko-ligjore”, i cili është protokolluar me nr. *** prot., datë 17.9.2015, nga sekretaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

25.8.2015, 9.9.2015 dhe 24.9.2015 për të kryer vëzhgimin dhe përgjimin e fshehtë në vende publike të personave nën hetim. Pas kryerjen së disa veprimeve hetimore, administrimit të transkripteve të bisedave të përgjuara të personave nën hetim, kryerjen e veprimeve në dinamikë, ka rezultuar se nuk është arritur të provohet veprimtaria kriminale e personave nën hetim. Veprimet hetimore, në fillim të regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 24.8.2015, janë kryer nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Me vendim të datës 1.9.2015 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit të mëparshëm dhe vazhdimin e hetimeve të këtij procedimi nga subjekti i rivlerësimit.

Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, më 3.9.2015, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendosjen në përgjim telefonik të një abonenti. Vendimet e përgjimit janë zgjatur sërish me vendimin nr. ***, datë 9.9.2015, për disa nga subjektet e dyshuar. Në përmbajtje të kërkesës për zgjatjen e afateve të përgjimit të bisedave telefonike subjekti citon se: *“Nga të dhënat e mësipërme rezulton se ka dyshime të arsyeshme për veprën penale ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe duke marrë parasysh faktin se personat nën hetim po bashkëpunojnë me njëri - tjetrin për grumbullimin e lëndës narkotike të kultivuar si dhe për gjetjen e tregut për shitjen e kësaj lënde narkotike është e domosdoshme që të përdoren mjetet për kërkimin e provës dhe, konkretisht, përgjimi i komunikimeve telefonike të personave nën hetim të personave që komunikojmë me personat nën hetim”*.

Në këto kushte, nisur nga lloji i veprës penale për të cilën ka filluar hetimi i këtij procedimi penal dhe në përputhje edhe me të dhënat e tjera të hetimit të këtij procedimi, do të ishte e nevojshme zgjatja e hetimit për një periudhë 20-ditore.

136. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 9.9.2015, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjatjen e afateve të hetimit për përgjimin e numrave të telefonave ... të personave në hetim me 20 ditë”*. Me autorizim për lejim të përgjimit ambiantal të datës 9.9.2015 subjekti i rivlerësimit ka autorizuar vëzhgimin dhe përgjimin e fshehtë në vende publike të personave nën hetim për një periudhë 15 ditë deri në datën 24.9.2015. Me autorizim për lejim të përgjimit ambiantal të datës 24.9.2015, subjekti i rivlerësimit ka autorizuar vëzhgimin dhe përgjimin e fshehtë në vende publike të personave nën hetim për një periudhë 15 ditë deri në datën 9.10.2015.

137. Në aktet penale të dosjes konstatohet nga Komisioni se oficeri i policisë gjyqësore me relacion të datës 10.2.2016 ka sugjeruar pushimin e çështjes penale për çështjen penale nr. ***, të vitit 2015. Në relacionin e tij ka relatuar, ndër të tjera, se për subjektin E.M numrat e përgjuar nuk përdoren nga ky subjekt, por nga persona të tjerë të pidentifikuar dhe rezultoi se të dy numrat celularë kishin biseda me interes dhe implikues në veprimtarinë kriminale në drejtim të kultivimit dhe shitjes së lëndës narkotike të llojit hashash në qytetin e Vlorës. Lidhur me subjektin F.A, nga interpretimi i këtij shtetasi dyshohej se merrej me aktivitet kriminal në drejtim të shitjes së lëndëve narkotike të llojit hashash. Nga ndjekja e të dhënave të këtij shtetasi nuk është bërë dot e mundur dokumentimi dhe vërtetimi i aktivitetit kriminal të dyshuar se kryhej nga ky shtetas dhe duke nisur nga kjo është bërë edhe ndërprerja e përgjimit.

138. Subjekti i rivlerësimit në përfundim të hetimit më 22.2.2016 ka vendosur:

- Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasve N.M, J.M, A.M, Q.M dhe S.B.
- Asgjësimin e materialeve të përgjimit CD-ve dhe procesverbalet e transkripteve të administruara për nevoja të hetimit.

139. Në konkluzion të sa më sipër, Komisioni konstatoi bazuar në dyshimet e arsyeshme të rezultuara në relacionin e oficerit të policisë gjyqësore për mënyrën e përfundimit të hetimeve se subjekti i rivlerësimit duhet të fillonte hetimet për personat e dyshuar. Sa më sipër mbështetet në ushtrim të funksionit të tij si prokuror, parashikuar në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se: *“Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë kod”* dhe subjekti i rivlerësimit duhet të kishte vijuar dhe të kryente hetime të mëtejshme lidhur me veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal.

140. Mbi konstatimet sa më sipër me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

141. Subjekti, pas njohjes me rezultatet e hetimit lidhur me konstatimet e Komisionit, depozitoi prapësimet si vijojnë: *“... sqaroj se pasi jam caktuar si prokuror i kësaj çështjeje, kam kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë disa herë vijimin për lejimin e përgjimit të bisedave telefonike të personave subjekt të këtij procedimi penal... Shpjegoj se pas veprimeve hetimore të mësipërme të kryera me qëllim provueshmërinë e faktit penal për të cilin ishte regjistruar ky procedim penal, si dhe individualizimin e përgjegjësive penale të secilit prej personave nën hetim, nuk është bërë e mundur të konstatohen elementë të anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Edhe vetë oficerët e policisë gjyqësore, referimi i të cilëve kishte shërbyer si bazë për fillimin e procedimit penal, në datën 10.2.2016 kanë sugjeruar pushimin e hetimeve në lidhje me këtë procedim penal. Nuk rezultuan gjatë hetimit fakte nga të cilat mund të nxirreshin të dhëna të sakta dhe me vlerë provuese dhe që në përputhje me njëra-tjetrën do të mund të krijonin bindjen lidhur me ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Lidhur me vijimin e hetimeve ndaj personave nën hetim, sa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, sqaroj se janë kryer në mënyrë të plotë dhe shteruese të gjitha veprimet e duhura nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provës (përgjimit telefonik dhe ambiental) të personave nën hetim, por indiciet e disponuara në rrugë operative nga policia gjyqësore nuk u harmonizuan me prova të tjera të rezultuara gjatë hetimit, në mënyrë që të përligjnin vijimin e hetimeve të mëtejshme dhe ngritjen e një akuze në ngarkim të personave nën hetim apo personave të tjerë që mund të shfaqeshin si subjekte të mundshme gjatë hetimeve të këtij procedimi penal”.*

Vlerësimi i Komisionit

142. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, deklarimeve të subjektit gjatë hetimit dhe shpjegimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, si dhe referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵⁷, arrin në konkluzionin se Komisioni ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, për sa kohë vlerësimi i Komisionit implikon drejtpërdrejt bindjen e brendshme dhe logjikën e subjektit të rivlerësimit mbi vlerësimin e provave dhe ecurinë e hetimit, për të vendosur vijimin e hetimeve, në aspekt të aftësisë së magistratit që nuk mund të vlerësohet si matës i aftësive të tij profesionale në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1, i ligjit nr. 84/2016, i cili referon te kriteret e ligjit nr. 96/2016, si kriteret që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, ligj i cili në pikën 4 të nenit 73, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë duke gjykuar korrektësinë dhe themelin e çështjes dhe duke zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

TË DHËNA NGA BURIMET ARKIVORE

⁵⁷http://kpa.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim_Ndini_Tavani_anonimizuar.pdf

143. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se për subjektin Arian Xhaferraj:

- i. me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019, te Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve në Prokurorinë e Përgjithshme është dhënë informacioni se ndaj subjektit të rivlerësimit Arian Xhaferraj nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore për periudhën 2006 – 2019;
- ii. nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;
- iii. nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontaktet e papërshtatshme me persona të papërshtatshëm (anëtar të organizatave kriminale), persona të dënuar apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);
- iv. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i kthen përgjigje Këshillit të Lartë të Prokurorisë se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi nr. ***, i vitit 2019, i cili lidhet me procedimin nr. ***, të vitit 2019, i cili është në fazën e hetimit;
- v. Prokuroria e Përgjithshme Drejtoria e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative ka informuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë se me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2019, ka dërguar informacion të veçantë;
- vi. ndaj subjektit të rivlerësimit ka tri materiale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe një material hetimor në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë: kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i mosfilluar; kallëzimi është trajtuar në relacion në seksionin e denoncimeve nga publiku; kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i mosfilluar trajtuar në relacion seksionin B kontrolli i figurës, në materialet e depozituara në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme; procedimi penal nr. ***, i viti 2020, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, trajtuar sa më sipër në relacion; procedimi penal nr. ***, i vitit 2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- vii. mbi bazën e vendimit për shpalljen e moskompetencës datë 1.8.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2018. Me vendimin datë 30.12.2019 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur shpalljen e moskompetencën dhe dërgimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, procedimi, i cili është trajtuar në relacion në kallëzimin nr. ***, të vitit 2020, i pushuar;
- viii. sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019, bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit;
- ix. nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2019, rezulton se është identifikuar pranë sektorit të protokoll arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme dy ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit;
- x. praktika nr. ***, e vitit 2017, ka të bëjë me ankesën e shtetasit I.B, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme kundër subjektit të rivlerësimit. Ankesa është marrë në shqyrtim nga drejtoria e hetimit dhe përfaqësimit në gjykim, në Prokurorinë e Përgjithshme. Me

shkresën nr. *** prot., datë 7.7.2019, është dërguar kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier;

- xi. praktika nr. *** prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit K.L kundër subjektit të rivlerësimit. Komisioni, nga përmbajtja e kësaj ankese, konstaton se janë të njëjtat pretendime të parashtruara edhe në denoncimin nr. ***, datë 12.10.2018, denoncues ****, depozituar në Komision dhe trajtuar në relacion në seksionin e denoncimeve nga publiku.

Vlerësimi i Komisionit

144. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar elementet e veprës penale objekt hetimi. Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit. Konstatohet se në aktin e diskutimit përfundimtar janë respektuar kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mënyrën e caktimit të tij. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit në dokumentin 1, dokumentin 2, dokumentin 3, dosjen 4 dhe dosjen 5, ka analizuar rrezikshmërinë e autorit, rrezikshmërinë e veprës penale, si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale në funksion të masës së dënimit të kërkuar. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

VLERËSIMI I DENONCIMEVE DHE VENDIMEVE TË PARAQITURA NË ANKESAT E SUBJEKTEVE DENONCUESE

145. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë bërë dy denoncime: nr. *** prot., datë 12.10.2018, nga shoqëria “****” dhe nr. *** prot., datë 27.11.2018, nga shtetasja M.M. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Komisioni nuk konstatoi *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për kriterin e aftësive profesionale.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

146. Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë e sjelljes profesionale të subjektit të rivlerësimit, pa gjykuar dinamikën e procedimeve lidhur me veprimet hetimore dhe ndjekjen penale, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e udhëheqjes së veprimeve hetimore në procedimet penale. Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit sistemit të drejtësisë penale si pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale hetimore. Zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e tij për tejkallimet e afateve të hetimit dhe nuk u vërtetua që këto tejkallime të kenë qenë të qëllimshme, por kanë ardhur për shkaqe të pavarura prej tij, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve, rrethanë e cila vlerësohet proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse ngarkesa në punë. Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas

nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj ka arritur një nivel kualifikues me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha denoncimeve, Komisioni konstatoi se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuar, për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale u konstatua se mangësitë e evidentuara nuk janë të tilla që të cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo që të kenë cenuar të drejtat e palëve në proces, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhim, Komisioni çmoi që subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, duke respektuar të drejtat e palëve dhe ka qenë efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, për këtë arsye, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes bazuar në provat e administruara, në raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arian Xhaferraj ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arian Xhaferraj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 15.3.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Etleđa ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj